



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Mësues për
Gjuhën shqipe dhe Letërsi.”**

ofruar nga

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.dr. Mimoza Kore

Prof.as. dr. Ema Kristo

Janar/2025

Tabela Përmbledhëse për Programin e studimit Master Profesional në “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi” ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Letërsisë dhe Departamenti i Gjuhës Shqipe
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Licensuar me VKM Nr.652 datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS 7238/1 Prot datë 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 291, datë 22.10.2020.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ETCS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët	-
15	Diplomë e dyfishtë	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	-
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2020-2021:5 PAE/2 PAK V.a 2021-2022: 5 PAE/0 PAK V.a 2022-2023 : 6 PAE/1 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2020-2021:43 studentë V.a 2021-2022: 37 studentë V.a 2022-2023 : 12 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

GVJ pasi u njoh me raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) për prgramin e studimit Master Profesional “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi” të ofruar nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, sipas parashikimit të ASCAL, kreu në datat 16-18 tetor vizitën ne Institucion për vlerësimin në nivel programi.

Ky program studimi është licensuar me VKM Nr.652 datë 14.09.2011 (60 ETCS.) dhe është riorganizuar sipas shkresës MASR 7238/1 Prot. datë 31.08.2018 me emërtimin Master Profesional “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi”. Ky program studimi zhvillohet në dy vite akademike dhe studenti duhet të realizojë 120 ETCS.

Për realizimin e tij janë angazhuar si staf akademik 18 PAE (5 nga departamente të tjera të FE) dhe 1 PAK. Staf i akademik ka shkallën e nevojshme të kualifikimit të këtij program studmi.

Mësimi zhvillohet në ambientet e Universitetit “A. Moisiu” Durrës, Fakulteti i Edukimit me një kapacitet dhe fasilite infrastruktorore të kënaqshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Për realizimin e tij nuk janë të nevojshme labororet.

Në këtë program studmi, për shkaqe të jashtme dhe objektive , numri i studentëve është në rënie.

Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi” ka në fokus të tij ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Gjithashtu, ky program siguron qëndrueshmëri në përgatitjen e mësuesve të gjuhës e letërsisë, fusha me interes kombëtar e prurje në fushën e Albanologjisë, në shërbim të ruajtjes së traditave, vlerave të gjuhës amtare. Programi mësimor pasqyron mbështetjen e vlerave dhe interesave kombëtare dhe nxit ruajtjen dhe pasurimin e tyre.

Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, të shprehur në Statutin e UAMD-së.

Në përputhje dhe me Statutin e UAMD-së, Neni 3 i tij “Ky program studimi ka për mision: të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/ shkencor; të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të angazhimit ndaj njeriut, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me individin dhe komunitetin”.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë nga ana e programit të studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi”

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof..Dr. Mimoza Kore dhe Prof.Asoc. Dr. Ema Kristo dhe gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga koordinatoresha teknike e ASCAL Znj. Alma Arapi.

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitet kryesorë të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë marrë nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsinë” i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit, i cili ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UAMD-së, etj.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht: Agjenda e hartuar paraprakisht u realizua duke zhvilluar takime me të gjithë aktorët që marrin pjesë në zbatimin e këtij program studimi.

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit, të Studentëve, Këshillimit dhe Karrierës, Alumni.
- Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Takim me Përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Vizitë në Sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe në bibliotekë

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm.

Nga ana tjetër, si pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, u realizua:

Vëzhgimi i mjediseve

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm vëzhgoi mjediset mësimore që ishin në dispozicion të programit të studimit, si: auditorë, laboratorë si edhe të mjediseve dhe literaturës së bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB dhe evidencat është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: “Mësues për Gjuhën Shqipe dhe letërsi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës është një institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. UAMD ofron programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>UAMD ofron programe studimi në përputhje me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Ky standard gjen shprehje në Statutin e UAMD (2021), Neni 7 i tij “Zhvillimi i veprimtarisë”, (Dokument 3/ Statuti i UAMD.PDF).</p> <p>Institucioni është i përkushtuar ndaj idealeve të qasjes, angazhimit, udhëheqjes, dhe të shërbimit të cilat sjellin përfitime praktike në fushën e arsimit të shtetit, kombit dhe komunitetit global duke u bazuar në pikën “Vlerat” në Planin strategjik të UAMD. Synimi mbetet një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar, njëherazi, dallimet vetjake. Këtë e përcaktojnë edhe dokumentet bazë të vetëqeverisjes së tij si Statuti i UAMD miratuar me Vendim Nr.33 date 20.04.2018 , Nr 41 Prot, Plani strategjik i UAMD, 2020-2025 miratuar me Vendim Nr.60, date 26.10.2020, nr. 1324 Prot dhe Rregullorja e Studimeve Universitare dhe Mendimi i Dekanit te FE.</p> <p><i>Referenca: Mendimi i Dekanit.</i> <i>Statuti i UAMD-se, Kreu I, neni 1, pika 1, 3, Vendim Nr 33. Date 20.04.2018 Aneksi 3.1. Plani strategjik i UAMD, 2020-2025 Kreu. 1, II, III, Vendim Nr.60. date 26.10 2020.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me	Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për gjuhën shqipe dhe Letërsi” ka në fokus të tij ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.



<p>qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Gjithashtu, ky program siguron qëndrueshmëri në përgatitjen e mësuesve të gjuhës e letërsisë, fusha me interes kombëtar e prurje në fushën e Albanologjisë, në shërbim të ruajtjes së traditave, vlerave të gjuhës amtare. Programi mësimor pasqyron mbështetjen e vlerave dhe interesave kombëtare dhe nxit ruajtjen dhe pasurimin e tyre.</p> <p>Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, të shprehur në Statutin e UAMD-së.</p> <p>Sipas Statutit të UAMD-së, Neni 3 i tij “Misioni”, deklarohet se “UAMD ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/ shkencor; b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; c) të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të angazhimit ndaj njeriut, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me individin dhe komunitetin.</p> <p>(Dokumenti 4. Statuti i UAMD.PDF).</p> <p>Ky program studimi, për të ndjekur ritmet e kohës dhe për të qenë në unitet me misionin e këtij Universiteti, e riorganizoi dhe një herë kurrikulën e tij për të qenë më bashkëkohore në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “ për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në vitin 2018. Në RVB evidenca që duhet t’i referohemi është e gabuar (Evidencë 73 , Vendim Nr1, dt 25.01.2018 I Rektoratit të UAMD.</p> <p>Riorganizimin e gjetëm në Evidencën 2.1 (Informacion për VKM në licensimin dhe riorganizimin e BA, MP; MSh)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dokumentin “Plani strategjik i UAMD 2020-2025” ku ka shpalosur misionin dhe visionin e tij për të ardhmen, si vijon:</p> <p>Misioni: Misioni i Universitetit “Aleksandër Moisiu” është të rrisë prestigjin dhe të sjellë shkencë dhe punësim nëpërmejt ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studiuarit gjatë gjithë jetës, aftësimit të personelit akademik, duke e bërë UAMD-në një qendër nevralgike të zhvillimit të dijes, inovacionit dhe ekonomisë.</p> <p>Vizioni: Universiteti “Aleksandër Moisiu” synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, sinjë realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në</p>




	<p>panoramën e arsimit të lartë. (<u>4 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</u>).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsi” plotëson kriteret në hartimin e tij dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UAMD-së, si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Ky program studimi synon në përgatitjen e mësuesëve të gjuhës e letërsisë shqipe sipas kompetencave profesionale në përputhje me zhvillimet e sotme shkollore dhe perspektivën e mësimdhënies si dhe të jenë të aftë për të kontribuar në formimin e zhvillimin e qëndrueshëm të mësuesve në Shqipëri.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për Gjuhën shqipe dhe Letërsi” është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> <p>Referuar RVB për kriterin 4, mësohet se Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi për Gjuhën shqipe dhe Letërsi mbështetet në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit .</p> <p>Në dokumentin “Plani strategjik i Universitetit 2020-2025”, Pika 1, institucioni thekson se “Vizioni që propozohet është ai i një Universiteti të lirë dhe autonom, pararojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, i aftë të udhëheqë studentët në mënyrë të përgjegjshme duke kontribuar denjësisht në tregun e punës, i aftë të influencojë botën akademike dhe të përballojë sfidat e bashkësisë shkencore ndërkombëtare.” Ky program studimi ka qëllim arsimimin e studentit i cili është dhe investimi më i mirë që ndikon thelbësisht në zhvillimin tërësor të vendit.</p> <p>Ky program studimi, ka synuar që studentët të pajisen me njohuri dhe kompetencat e nevojshme të karakterit teorik e praktik të përgatitjes së mësuesve të gjuhës e letërsisë shqipe në nivel lokal e kombëtar. Ai synon të plotësojë nevojat e tregut të punës në nivele lokale, kombëtare dhe më gjerë. Zbatimi i programit ndiqet me kujdes nga Departamenti i gjuhës shqipe dhe Departamenti i letërsisë me qëllim marrjen në konsideratë të nevojave të tregut të punës si dhe një administrim të kujdesshëm të programit mësimor dhe krijimin e mundësive për përditësimin e kurrikulave në përputhje me këto nevoja dhe strategjitë për zhvillimin kombëtar. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien</p>

	<p>ndesh me interesat dhe programet e tjera të ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të lartë.</p> <p>(Referenca: Evidencë 73, Vendim Nr.1, dt 25.01.2018 I Rektoratit të UAMD.</p> <p>Evidencë 4, Plani strategjik kombëtar</p> <p>Evidence 46, Raporti vjetor mbi kerkimi shkencpublikimet e partneritete</p> <p>Evidence 73, Analizë e tregut të punës, Evidence 7. Strategjia e ndërkombëtarizimit)</p>			
Konkluzione	<p>UAMD ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Institucioni ka kapacitetet e nevojshme dhe burimet akademike për ofrimin e programeve në fushën e Albanologjisë e shkencave humane. Statuti dhe Rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij mbështetur në <i>misionin, qëllimin</i> të përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të Statutit të UAMD dhe <i>qëllimit</i>, neni 1 i Rregullores së UAMD. Drejtimit prioritare akademike të programit të studimit gjenden në nenet 59, 63 të Statutit të UAMD dhe në nenet 41, 45 të Rregullores së UAMD, të cilat përputhen me drejtimit e institucionit.</p> <p>Departamenti i Gjuhës shqipe dhe Letërsisë i cili ka në përgjegjësi realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, kanë gjithësej 15 pedagogë, nga të cilët 8 PAE në departamentin e Gjuhës shqipe, 7 pedagogë në departamentin e Letërsisë. Gjithashti janë të ftuar 3 pedagogë PAE nga departamente të tjera të FE dhe 1 PAK.</p> <p>Raporti midis PAE dhe PAK është në favor të PAE.</p>




	<p>Referuar të dhënave për mbulimin e ngarkesës mësimore, nga personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar për realizimin e të programit të studimit për vitin akademik 2021-2022, rezulton se: PAE mbulon pjesën më të madhe të orëve mësimore.</p> <p>Referuar: <i>(Evidencë 8.2 Staf i i brendshem dhe i jashtem (MP) i angazhuar sipas kurseve perkatese.pdf)</i></p> <p><i>(Evidenca 61 Staf i brendshem dhe i jashtem (MP) i angazhuar sipas kurseve perkatese.pdf).</i></p> <p><i>(Evidencë 5, Rregullore e UAMD-së)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Edukimit (2019), Neni 1, shprehet se Fakulteti i Edukimit (FE) është njësi kryesore e UAMD-së që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe veprimtarisë mesimore – kërkimore – shkencore në përputhje me misionin ligjor të kësaj njësie.</p> <p>Në Nenin 42 të Rregullores përcaktohet se “FE ofron programe studimi të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të tretë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sistemin amerikan UsCr”. Në nenin 46, pika 3 e Rregullores, deklarohet se “Programet e studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara me karakter praktik profesional në një fushë të caktuar. Këto programe realizohen me 60 ose 120 kredite dhe zgjatja e tyre normale është një ose 2 vite akademike, në përfundim lëshohet diploma “Master Profesional”. (Evidencë 20. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf)</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore¹³ sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin 72MP0011S</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore.</p>




<p>jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit si pjesë e Universitetit "Aleksandër Moisiu" zbaton Statutin e Universitetit, Kreu II, i cili është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përshtatje me misionin dhe objektivat e tij. Programi studimit MP/GJL është riorganizuar mbështetur në Udhëzim nr. 31/ datë 29/12/2017 për "Riorganizimit të Programit të studimit MP/GJL, viti 2018", pikat nr. 4 dhe nr. 6, si dhe Udhëzim nr. 29, datë 10.09.2018, <i>Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Shqipe e Departamenti i Letërsisë, i cili përbëhet nga anëtarë të kualifikuar me kompetenca e kontribute në fushën e gjuhës shqipe e letërsisë pasqyruar në CV-të dhe në Dosjet e vetëvlerësimit dhe ofron një program studimi të shpërndarë në dy cikle studimi. Gjithashtu programi i studimit mbulohet edhe nga personeli akademik i departamenteve të tjera të Fakultetit të Edukimit, i cili ka në përbërjen e tijkëto departamente: • Departamenti i Gjuhës Shqipe • Departamenti i Gjuhëve të Huaja • Departamenti i Letërsisë • Departamenti i Pedagogjisë • Departamenti i Psikologjisë • Departamenti i Sociologjisë • Qendra e Edukimit në Vazhdim <p>Të gjithë këto departamente ndihmojnë në përmbushjen e qëllimeve akademike që ka programi i studimit MP/GJL.</p> <p><i>Evidencë 20, Rregullore e FE</i> <i>Evidencë 4, Statuti I UAMD</i> <i>Evidenca 8., Marrëveshjet për riorganizim</i> <i>Evidenca 9. CV</i> <i>Evidencë 10 Dosja e vetvlerësimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë</p>	<p>MP/GJL është në të njëjtin drejtim me profilin e Fakultetit të Edukimit me <i>misionin</i> dhe <i>qëllimet</i> e Universitetit sipas nenit 3 dhe 4 e Statutit të UAMD. Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi për Gjuhën</p>




<p>profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>shqipe dhe Letërsinë” përcaktohet se “Programi i studimit ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Gjuhës shqipe dhe letërsisë, në Fakultetin e Edukimit (FE), të Universitetit “Aleksander Moisiu”. Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizur për t’ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut. Për të garantuar cilësinë e programit të studimit Master Profesional në “Mësues për Gjuhën shqipe dhe Letërsi”, UAMD dëshmon se ka rekrutuar PAE dhe PAK të kualifikuar në fushën përkatëse, si dhe ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sikurse DAR/ZAV në disa rrethe të vendit për të realizuar praktikat profesionale të studentëve.</p> <p><i>Evidence18 Praktikak, rregullore e mirefunksionimit.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Ky institucion i Arsimit të Lartë vazhdon të jetë në kontakt me studentët e diplomuar, tashmë mësues përmes Qendrës së Edukimit në Vazhdim. Kjo qendër ndjek, por dhe është pjesë aktive e trajnimit të mëtjshëm të mësuesve duke ndjekur politikën e edukimit në vazhdim.</p> <p>https://uamd.edu.al/qendra-per-edukim-ne-vazhdim/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për Gjuhën shqipe dhe Letërsi” është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Edukimit dhe Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, përgjegjës për programin e studimit të ofruar në institucionin e AL, UAMD. Për të garantuar cilësinë e programit të studimit Master Profesional në “Mësues për Gjuhën shqipe dhe Letërsi” UAMD dëshmon se ka rekrutuar PAE dhe PAK të kualifikuar në fushën përkatëse, si dhe ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sikurse DAR/ZAV në disa rrethe të vendit për të realizuar praktikat profesionale të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>FE demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UAMD, dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi për Gjuhën shqipe dhe Letërsinë”.</p> <p>Në Statutin e UAMD, Neni 2, përcaktohet se “<i>Statuti I UAMD përcakton hollësisht: organizimin, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrative dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e UAMD-së</i>”.</p> <p><i>(Evidenca 3. Statuti i institucionit).</i></p> <p>Nga Statuti i UA buron Rregullore e Universitetit të Arteve e cila në Nenin 3, përshkruan se “<i>Qëllimi i kësaj Rregullore është të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator, të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore, kërkimore -shkencore dhe administrative të Universitetit</i>”. (<u><i>5 Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></u>).</p> <p>Bazuar në këto dokumente kyçe të funksionimit në nivel institucional, janë gjeneruar dokumentet e tjera rregullore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti, programi studimor, etj., si: Kodi i Etikës, Rregullore e NJSBC, Rregullore e bibliotekës, Rregullore e sekretaries mësimore, Rregullore e fakultetit, etj., të cilat përbëjnë themelin për të siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (<i>Referuar tërësisë së dokumenteve rregullatore të UAMD, Urdhrave dhe akteve të tjera administrative, të pasqyruara në e-ASCAL për qëllime akreditimi</i>).</p> <p>Ligji për Arsimin e lartë, 2015, neni 57 dhe 58; neni 51 i Statutit UAMD; neni 24, 25 i Rregullores së FE, përcaktojnë detyrat e personelit dhe statusin e tyre. Gjithashtu, mbështetur në nenin 11, pika f, detyrat dhe përgjegjësi të tjera respektive janë të përcaktuara në marrëveshjet e firmosura midis drejtuesit të departamentit dhe anëtarëve të departamentit, në çdo fillim viti. Institucioni siguron</p>




	<p>gjithmonë bashkëpunime mes njësive të personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Duke u bazuar në Rregulloren e Cilësisë së NJSBC, janë caktuar detyrat e kordinatorëve të programit të studimit apo personelit nëpërmjet përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Gjithashtu Departamenti ngre grupe pune për çështje të ndryshme administrative, si "Ngritje komisioni për procedurën e pranimeve, transferimeve dhe aplikimeve për programin e dytë të studimit, Master Profesional, Mësues për Gjuhë shqipe e Letërsi "Propozim për ngritje komisioni për procedurën e vlerësimit dhe rekrutimit të stafit të ri për vitin akademik.</p> <p><i>Evidencë 4, Statuti I UAMD</i> <i>Evidencë 20, Rregullore e FE</i> <i>Evidenca 8, 1. Marrëveshjet</i> <i>Evidenca 11, Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca 12. Vendimi mbi kordinatorët</i> <i>Evidenca 24, Urdhër Dekanati</i> <i>Evidencë 15, Kriteret e rekrutimit të lektorëve të jashtëm</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Duke qenë Master në mësuesi për gjuhën dhe letërsinë është bërë marrëveshje me DAR të rrethit të Durrësit për zhvillimin e Praktikave mësimore në shkollat e këtij rrethi. (<i>Evidencë 18, Marrëveshje me DAR</i>)</p> <p>Për rritjen profesionale e shkencore janë ftuar lektorë të jashtëm nga ASA. Janë zhvilluar Leksione të hapura me prof. Xh Lloshin, T. Plangaricën, Emil Lafen e etj <i>Evidencë 37 Dosja e raportimit të aktiviteteve.</i></p> <p>N evidencën 16, referuar RVB (<u>16.Aktivitetet shkencore të miratuara nga Rektorati DEP GJUHES LET.pdf</u>) nuk bëhet fjalë për konferencë studentore, por për pjesëmarrje të 4 pedagogëve në aktivitete shkencore, çka na duket shumë pak për dy departamente dhe ato të zhvilluara më 2021</p> <p>Në RVB i referohen edhe <i>Evidencë 19, Rregullore e drejtorisë së projekteve e marrëdhënieve me jashtë</i>, e cila është një rregullore e miratuar më 2020, por nuk jepen diku projektet e fituara.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi për Gjuhën shqipe dhe Letërsi" UAMD dëshmon se ka nënshkruar marrëveshje me institucione të fushës përkatëse në sistemin arsimor,</p>




<p>marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e temave kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. Rregullorja e Praktikës profesionale, në nenin 3 dhe 4 përcakton strukturat përgjegjëse për organizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e praktikës mësimore. Koordinator i programit të studimit ndjek procedurën e praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidence 18, Udhëzues i praktikave</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nuk u gjend ndonjë raport analitik i njësisë përgjegjëse për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe aq më tepër periodike. Evidenca e referuar ne raport dhe kontrolluar perj nesh në setin e dokumenteve, nuk bën fjalë për një të tillë (<i>Evidencë 23 Raporti vjetor analizues UAMD</i>)</p> <p>Në <i>Evidencë 47 Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i>, hartuar nga UAMD gjenden bashkepunime të stafit akademik me universitetet të tjera Europiane, e këtu janë të përfshirë edhe pedagogë nga këto 2 njësi përgjegjëse për programin e studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD dëshmon se ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, organizata në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. GVJ sugjeron që Departamenti të forcojë praktikën e mirë të raportimit periodik, jo vetëm për mbarëvajtjen e praktikës profesionale, por edhe për përfitimet nga bashkëpunimet me aktorë, institucione dhe organizma të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Organizimi i programit është bërë me module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) mbështetur në pikën 2, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, mbështetur te pika 4 dhe 6 e Riorganizimit të Programit të studimit MP/GJL në përputhje me Udhëzimin nr 31, datë 29/12/2017. Totali i Krediteve (ECTS), 120 ECTS. Kohëzgjatja normale në vite, 2 vite akademike, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në nenin pika 3 e Rregullores së FE</p> <p><i>(Evidencë 20 , Rregullore e Programit te studimit MP/GJL)</i></p>
<p>Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Programi i studimit MP në GJL synon formimin e shprehive të veçanta në profesionin e mësuesit të APU mbështetur dhe pasqyruar dhe në Raportin “Studimi periodik për tregun e punës pas daljes së studentëve” dhe mbështetur në Riorganizimin e Programit të studimit MP/GJL.</p> <p>Programi i studimit MPGJL ndihmon formimin e shprehive të veçanta si mësues, staf administrativ, punonjës në drejtimin e arsimit, gazetarë.</p> <p><i>(Evidence 72, Studim tregu)</i></p>

<p>paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në planin mësimor të këtij program studimi, (evidence 6 kURRIKULA MP plani.pdf) Praktika mësimore është planifikuar 1 ditë/15 javë dhe zhvillohet semestrin e 4-t.</p> <p>Nuk ka një program të hartuar për Praktikën Mësimore që kryejnë studentët. Në <i>evidencën 18 (Praktikat, rregullore e mirefunksionimit.pdf)</i> të hartuar nga UAMD thuhet se programi i praktikës hartohet nga DAR dhe IZHA. Ato caktojnë mentorin që do të udhëheqë studentin dhe do ta ndjeki në këtë process. Atij I vihet në disupzicion një tabelë (gjendet në evidencën 18) me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë praktikanti, të cilat nuk janë të ndara në kredite. Në vlerësimin përfundimtar duhet të marrë pjesë drejtuesi I njësisë dhe përfaqësues të IZHA. Megjithëse në RVB thuhet se <i>Programi i studimit parashikon ngarkesën në kredite të përcaktuara për praktikën profesionale, me ekuivalentim sipas VKM 41, pika 2.4 dhe 2.5, Udhëzim nr. 31/ datë 29/12/2017 për "Riorganizimit të Programit të studimit MP/GJL, viti 2018", pikat nr. 4 dhe nr. 6, si dhe Udhëzim nr. 29, datë 10.09.2018. ne nuk mundëm ta verifikonim credited.</i></p> <p>Në <i>evidencën nr 18, 1, Dosja e praktikave, paraqitet gjithë dokumentacioni i praktikës profesionale.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë "Master Profesional GJL formon mësues të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë dhe është në vazhdim e plotësim i ciklit të parë Bachelor Gjuhë Letërsi-Anglisht. Programi Master profesional i studimit për "Gjuhë Letërsi"i përgjigjet fushës përkatëse dhe kërkon të pajisë studentin me njohuri teorike, duke integruar njohuritë e shkencave edukuese me ato shoqërore; të pajisë studentin me kompetencat e duhura teoriko-praktike dhe të pajisë studentin me aftësi tekniko-metodologjike, për të seleksionuar, përpunuar informacion e për ta përdorur me efikasitet. Shih dhe (72 Evidencë Studim tregu MPGJL.pdf)</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me</p>	<p>Programi MPGJL në fushën e mësuesisë organizohet me 120. Kërkesa e Ligjit kërkon që 25% pra 30 kredite të jenë në të të formimit të përgjithshëm psiko pedagogjik sipas VKM në fuqi. Në</p>




<p>120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.</p> <p>Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>program, çka theksohet edhe në RVB këtij formimi i është lënë 25 kredite, duke nënkuptuar gabimish 25%. Në program ka lëndë të këtij formimi si: Shkenca të edukimit, Psikologji Edukimi, Politika dhe Legjislacioni në Arsim, Shkenca Edukimi etj. (Evidenca 6 Kurrikula e MP)</p> <p>Janë bërë propozime për unifikim të kurrikulës në rang vendi me programe të ngjashme në Universitet të tjera. (Evidence 28 propozimet per MP profili Gjuhe Letersi)</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i këtij MPGJL në 70% të tij është i ngjashëm me programet e ngjashme në Universitetet e tjera të vendit. Kjo përputhshmëri është edhe më e dukshme në lëndët e formimit psiko pedagogjik, të cilat janë të njëjta. Kjo lehtëson lëvizshmërinë e studentëve dhe përballjen e njëjtë në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Nuk është bërë ende nga MASR kodifikimi i këtij program studimi. Në këtë situatë është vetë UAMD që ka bërë një kodifikim të brendhëm dhe duke i caktuar këtij programi kodin: <i>S72MS0188</i></p>




Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se ky standard plotësohet nga institucioni, sepse i përmbush të gjitha kërkesat ligjore. Programi është organizuar dhe realizohet në përputhje me formimin shkencor e psiko pedagogjik të studentëve. Gjithashtu është I ngjashëm në masën 70% me programet simotra në institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësia kryesore FE si dhe njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit MP në “Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsi” përmbushin detyrimet ligjore për këtë program studimi sipas legjislacionit Ligji I Arsimit të lartë 2015/80 për organizimin dhe strukturën akademike. Ky fakultet ka 7 njësi bazë:</p> <p>Departamenti i gjuhës shqipe, Departamenti i Letërsisë, Departamenti i gjuhëve të huaja, Departamenti I Psikologjisë, Departamenti i Sociologjisë, Departamenti i Pedagogjisë, Qendra Edukim në vazhdim (QEV).</p> <p>Njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi janë Departamenti i Gjuhës shqipe dhe Departamenti i Letërsisë . Këto departamente</p>

përbëhen në total nga 8 anëtarë të stafit akademik PAE në Gjuhësi dhe 7 PAE në departamentin e Letërsisë. Prej tyre 4 zotërojnë titullin akademik Profesor i Asociuar, 11 zotërojnë gradën shkencore doktor i shkencave.

Departamenti i Gjuhës Shqipe	2022-2023	
	PAE	PAK
Prof.Dr		
Prof.As.Dr	2	
Dr	6	
MSc		
Total	8	0

Departamenti i Letërsisë	2022-2023	
	PAE	PAK
Prof.Dr		
Prof.As.Dr	2	
Dr	5	
MSc		
Total	7	0

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në

Njësitet përgjegjëse, Departamenti i Gjuhës shqipe dhe ai i Letërsisë, nuk kanë në dispozicion staf administrativ në department, por për gjithë procesin mësimor si dhe me studentët është angazhuar një nga sekretaret e Sekretarise që përgjigjet vetëm për këtë program studimi.




legjislaconin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.									
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Departamenti i Gjuhës shqipe dhe Departamenti i Letërsisë ka përcaktuar koordinatorin e programit MP MGJSHL i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Ai është caktuar me Vendimin Nr. PROT.4502, DATË 23.12.2021, Protokolluar në FE (evidence nr 12 Vendimi për kordinatorin)</p> <p>Koordinatori i këtij programi studimi prof.as H.Mukli është pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Ai ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.</p>								
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Njësia kryesore FE dhe njësitë bazë që mbulojnë këtë program studimi i plotësojnë kriteret sipas legjislaconit në fuqi me staf akademik me gradat përkatëse shkencore. Nevojitet një staf akademik, sekretare pranë departamenteve, punë që mbulohet nga një nga anëtarët e sekretarisë mësimore. Programi i studimit ka një kordinator</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të	Gjithë dokumentacioni vënë në dispozicion dhe nga ajo çka u pa




<p>ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>në vend GVJ nxjerr konkluzionin se si DGJSH dhe D ashtu dhe Njësia kryesore kanë informacionin mbi bazën ligjore për organizimin, strukturën dhe silabuset e këtij program studimi. bazë DGJSH dhe DL, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në (Evidenca 6, Plani mësimor) gjenden të gjitha të dhënat e planit mësimor, si: Semestri kur zhvillohet lënda, kreditet përkatëse, Pedagogu me gradën shkencore përkatëse, orët në auditor, shuma e orëve për semëstër. Plani mësimor është ndërtuar mbi udhëzimet, VKM dhe rregulloret e UAMD.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë informacionin që i duhet studentit për ta ndjekur. Në rregulloren e UAMD (Evidencë 5 <i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i> në nenet 47, 56, 57) janë dhënë të gjitha informacionet që i duhen studentit për të ndjekur këtë program, si kushtet që duhet të plotësojë, dokumentacioni përkatës, kriteret për t'u transferuar në një program të afërt studimi brenda institucionit ose në institucione të tjera të Arsimit të lartë që kanë programe të ngjashme. Njoftimi i studentëve realizohet nëpërmjet faqes online mbi transferimet, ku përcaktohen afatet e dokumentacioni.</p> <p>Gjithashtu të gjitha të dhënat që i duhen si informacion studentit të MP janë përshkruar në (Evidencë 31, <i>Rregullore e MPGJL neni 24-30</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në</p>	<p>Programi i studimit MPGJL përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara (Evidencë 87-106 32) për secilën lëndë, në të cilat është dhënë në formatin e përcaktuar: Titullari/pedagogu i lëndës me gradën përkatëse. Ngarkesa në kredite Tipologjia e lëndës: Viti Akademik Lloji i lëndës: (psh. e detyrueshme) Kodi i lëndës: Adresa elektronike e pedagogut të lëndës: Përbërja e strukturës së programit të studimit MPGJL dhe hartimi i syllabuseve është bërë</p>




përputhje me formatet e miratuara.	sipas akteve ligjore e nënligjore të VKM nr 41, datë 24.1.2018 87-106			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga vëzhgimet në vend dhe bisedat me stafin akademik vërejtëm se Programi i studimit MP MGJSHL në fillim të çdo viti akademik në mbledhjet e departamentit diskutohen arritjet dhe problematikat e hasura me qëllim që nëse ka propozime për ndryshim apo sistemim të bëhet e mundur në kohën e duhur. Përsa i përket literaturës ajo është në përditësim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Ndryshimet eventuale miratohen çdo fillim viti akademik			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me kërkesat e MP. Këto janë të shprehura mirë në Rregulloren e programit të studimit. Plani mësimor, syllabuset janë hartuar në përputhje me VKM nr 41, datë 24.1.2018. Ato japin informacionet e nevojshme për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Pas përfundimit të këtij program studimi MP studentët sipas Ligjit të Arsimit të lartë nuk kanë të drejtë të ndjekin Doktoraturë në Gj-L, por si mësues me formin e nevojshëm psikopedagogjik ata mund të vijojnë studime dhe trajnime të mëtejshme.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të	Programi i këtij MP është ndërtuar mirë në lëndë/ module sipas VKM në fuqi. Ato janë shtrirë në semestra duke u zhvilluar në fillim ato të formimit bazë, formuese, karakterizuese e me zgjedhje. Të gjitha janë të vlerësuara në kredite duke ruajtur dhe raportin e kërkuar midis tyre, duke realizuar në fund objektin e këtij programi.

<p>programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë, është bërë në përputhje me akte ligjore e nënligjore të VKM-së nr.41, 24.1.2018.</p> <p>Ky program është për mësues të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe ngjashmëria me programet ndërkombëtare është bërë për lëndët e metodikave të mësimdhënies, të teknologjisë së mësimdhënies për t’u përshtatur edhe me programet e shkollave tona. Këto lëndë sigurojnë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në këtë program studimi lëndët teorike me ato për aftësimin praktik kanë një raport të drejtë që mundësojnë përgatitjen e mirë të studentëve. Lëndët /silabuset të përfshira në kurrikul ofrojnë njohuritë e duhura teorike dhe aftësimin e duhur profesional, mbështet plotësisht fitimin e aftësive e kompetencave duke ndihmuar mobilitetin dhe integrimin në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimi me grupin e RVB dhe në takimet e zhvilluara me anëtarë të stafit akademik na u pohua përditësimi i silabuseve me më të rejt e fushave që mbulojnë lëndët e këtij program. Studentëve iu jepet literaturë e detyruar dhe facultative. Shumen ga pedagogët kishin botuar libra të tyre</p> <p>Këtë e konstatuam edhe me punonjësit e bibliotekës së këtij fakulteti si dhe me kontrollin fizik te literaturës.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e</p>	<p>Mendojmë se ky program studimi i jep njohuri, kompetenca dhe aftësi studentit për tregun e punës. Ai i përgatit mësuesit e ardhshëm me njohuri të avancuara në lëndët bazë, por dhe me kompetenca</p>




dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	psikopedagogjike të domosdoshme për mësuesin e ardhshëm të Gjuhë Letërsisë.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Me njohuritë që marrin studentët në këtë program studimi sigurojnë njohuri të qëndrueshme dhe kanë mundësi avancimi, megjithëse deri më tani nga MASR nuk lejohet vijimësia në shkollën doktole pasi përfundon këtë program studimi, i cili finalizohet vetëm me punësim si mësues.			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të syllabuseve, programit dhe planit mësimor arrin në përfundimin se ky program studimi krijon njohuri të thelluara dhe pajis studentët me aftësi për të qenë mësues për gjuhë dhe letërsinë shqipe në shkollat tona.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, Departamenti i Gjuhës shqipe dhe ai i Letërsisë janë konsultuar dhe studiuar paraprakisht çka paraqitet në evidencën nr.72 “Studimi (periodik) për tregun e punës, para daljes së studentëve” Duke qenë se UAMD ka marrëveshje dhe bashkëpunimi me 102 institucione është mbajtur parasysh edhe bashkëpunimi me to, për të përshtatur programet lëndore, për kryerjen e trajnimeve jashtë kurrikulare, trajnime të personelit akademik në fusha specifike, përmirësimin e infrastrukturës në dispozicion të mësimdhënies dhe praktikave mësimore, zhvillimin e projekteve të përbashkëta apo bashkëpunimeve të ngjashme.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	Në RVB theksohet se Institucioni mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar nëpërmjet plotësimit të pyetësorit me Alumni, duke iu referuar evidencës nr 60. “Pyetsor i studentëve për

<p>tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>vlerësimin e programit”. Kjo iu takon studentëve aktualë dhe jo atyre që kanë përfunduar studimet. Gjithashtu edhe për këta të fundit, pyetsori duhet të ishte më i plotë për të gjithë elementet e përgatitjes së tyre.</p> <p>UAMD ka një zyrë specifike për monitorimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të punësimit të të diplomuarve të tij nëpërmjet Degës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit. Në evidencën nr. 30 “ Të dhëna Alumni” jepen për gjithë UAMD studentët e punësuar (shumë pak nga programi në shqyrtim) dhe nuk ka tregues apo të dhëna të tjera ku tregohet se si tërhiqet mendimi dhe vlerësimi i tyre për këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Ka pasur një tryezë me përfaqësues nga të gjitha universitetet e vendit që zbatojnë të njëjtin program studimi, udhëhequr nga MASR për unifikim të programit në shkallë kombëtare. Në pritje të hapave të mëtejshëm nuk kanë berë kohët e fundit ndryshime.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se lidhja, tërheqja e mendimit nga studentët aktualë dhe ata Alumni duhet të jetë jo sipërfaqësore, por mendimi i tyre duhet të jetë parësor në përmirësimin e kurrikulës dhe gjithë elementeve të programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				


<p>Standardi II.6</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit</p>	<p>Në <i>Evidencën nr.4</i> “Plani strategjik” përshkruhen qartë objektivat e këtij program studimi të cilat janë në përputhje edhe me ato të Fakultetit të Edukimit dhe UAMD. Programi ka si mision të kryejë mandatin e tij arsimor dhe shkencor në mënyrë të kënaqshme dhe në hap me kohën, të promovojë Arsimin e Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke</p>




shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	gjeneruar ide të reja dhe moderne, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim shkencor. përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe gjithëpërfshirje në kërkimin shkencor, nëpërmjet ofrimit të hapësirave për më shumë komunikim, diskutim të lirë dhe të gjallë.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimi me grupin hartues të raportit RVB na u bë me dije që ky kriter nuk plotësohet, sepse kanë hasur vështirësi në ndarjen e grupeve mësimore, ku përgjegjësia mësimore e shkencore është më e drejtpërdrejtë, me gjithë urdhrin e Rektorit Puna shkencore dhe ajo mësimore mbikqyret rregullisht nga kordinatori dhe përgjegjësit e departamenteve. <i>evidence.nr 42 "Fillimi i procedurës për ndarjen e grupeve"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në aktivitetet e zhvilluara nga këto dy departamente janë përfshirë dhe studentët na u tha nga stafi e studentët. Në <i>evidencën nr. 33 "raporte aktivitetsh"</i> në fakt nuk pamë një aktivitet konkret, por në mënyrë të përgjithshme jepet një raport i Qendrës së Karrierës me datën e këshillimit të studentëve, apo me takime me Alumnin, por jo të dhëna konkrete, kështu që nuk krijohet një ide për to. <i>Në evidencën nr. 34 "Raporte te konferencave studentore"</i> nuk pamë aktivitete shkencore, por nisma individuale të studentëve për të dhënë ndihma bamirësie.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni si p.sh. financimi i projekteve studimore me finalizim botim me impakt faktor ose scopus. Janë mbështetur financiarisht një pjesë e mire e stafit akademik në botime në revista shkencore me Impact faktor, e gjithashtu në projekte. Stafi akademik na bëri me dije se janë mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në konferenca jashtë UAMD si dhe për botimet në revista shkencore të kushtueshme. Keto i gjetëm edhe në dokumentacion <i>(Evidencë Evidencë 44, Rregullore e kerkimit shkencor; Evidencë 38, Plan buxheti afatmesëm), https://uamd.edu.al/shpallet-lista-e-projekteve-kerkimore-shkencore-fituese-ne-uamd</i>

Konkluzione	<i>GVJ mendon se duhet punuar më shumë me studentët dhe alumin për të terhequr mendimin dhe përvojën e tyre si një nga hallkat më të rëndësishme të realizimit të këtij programi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Nuk janë krijuar grupet lëndore. Të dy departamentet i mbështesin projektet kërkimore-shkencore të reja dhe sigurojnë bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor (https://uamd.edu.al/shpallet-lista-e-projekteve-kerkimore-shkencore-fituese-ne-uamd/)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Ka një angazhim nga të dyja stafet e këtij programi për kërkim shkencor. Nuk ka analiza apo pjesëmarrje të studentëve në to. Në linkun që i referohet RVB jepen konsiderata të përgjithshme të UAMD, por jo raste konkrete. (https://uamd.edu.al/studentet-dhe-kerkimi-shkencor/).
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në fushën e programit të studimit, Departamenti Gjuhë Shqipe dhe i Letërsisë ka organizuar konferenca dhe ëorkshope, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Këto na u vunë në dukje nga stafi dhe përgjegjësat e departamenteve, por linku bashkangjitur raportit nuk na jep ndonje të dhënë (https://uamd.edu.al/studentet-dhe-kerkimi-shkencor/)
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun	Ky program studimi nga stafi mendohet se është konkurrues në tregun kombëtar të punës (pa specifikuar, pse). Meqenëse zhvillohet në gjuhën shqipe, mundësia për tregun ndërkombëtar




kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	është gati e pamundur, vetëm në qendrat alabanologjike ku mësohet gjuha shqipe.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga tregu i punës, nga alumni, nga shkollat ku janë punësuar studentët që përfundojnë këtë MP. Njësia interesohet për studentët që kanë përfunduar studimet, për aftësitë që kanë fituar për të marrë licencën.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Ky program studimi përputhet me aktet ligjore e ndërkombëtare (Europiane) për profesionet e rregulluara			
Konkluzione	GVJ mendon se duhet të ishin shfaqur konkretisht aktivitetet shkencore të të dy departamenteve që mbulojnë këtë program studimi si dhe përfshirja e studentëve në to.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Gjatë realizimit të këtij programi studimor, aplikohet një shumëllojshmëri metodash të avancuara të mësimdhënies dhe të të nxënit, të cilat përfshijnë leksione, seminare, lexime të strukturuar, projekte kërkimore, analiza të dokumenteve, punë në grup, prezantime, zgjidhje të problemeve dhe forma të tjera të miratuara. Këto metoda mbështeten në dispozitat e përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit (FE) dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD).</p> <p>Në përputhje me nenin 60, pika 5 të Rregullosës së UAMD-së dhe dispozitat përkatëse të Rregullosës së FE-së, procesi mësimor organizohet në një format të integruar, ku i njëjti pedagog është përgjegjës për realizimin e leksioneve dhe seminareve. Ky model synon të sigurojë vazhdimësi dhe koherencë në transferimin e dijeve dhe zhvillimin e aftësive të studentët.</p> <p>Format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies përfshijnë, ndër të tjera: leksionet, detyrat e kursit, projektet kërkimore, orët e hapura dhe çdo metodë tjetër të miratuar nga autoritetet përkatëse akademike. Pedagogët kanë autonominë dhe detyrimin profesional për të kombinuar këto metoda në përputhje me objektivat e parashikuara në programin mësimor të lëndës, duke u bazuar në nevojat individuale dhe kolektive të studentëve, si dhe në kërkesat e tyre për përvetësimin e njohurive.</p> <p><i>Evidenca 20: Rregullore e FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra,</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimet e realizuara me personelin akademik të Institucionet, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar të RVB-së, u konstatua se gjatë zhvillimit të këtij programi mësimdhënia realizohet në një formë inovative përmes zhvillimit të moduleve të mirëorganizuar, të cilat</p>

<p>metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>inkurajojnë mendimin dhe punën e pavarur. Programi i studimit MPGJL ofron një kurrikul të pasur me lëndë të cilat janë në përputhje me natyrën dhe fushën e studimit. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar metoda të ndryshme inovative mësimdhënie dhe mësimnxënie. Gjatë zhvillimit të lëndëve të programit master në GJL, gjithashtu përdoren metoda të ndryshme, duke përfshirë leksionet, seancat e ushtrimeve dhe diskutimeve, si dhe prezantimi e diskutimi i materialeve të marra nga literatura.</p> <p><i>Evidenca 45: Manual i metodologjive ndërvepruese</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Qendra për Edukimin e Vazhduar ka organizuar trajnime të specializuara për stafin akademik, të cilat kanë synuar përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe forcimin e aftësive didaktike. Gjatë bisedave të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, është vërejtur se këto trajnime kanë gjetur zbatim praktik në procesin mësimor, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies dhe në përmbushjen e pritshmërive institucionale për zhvillimin profesional të stafit akademik. Këto masa kontribuojnë në një mënyrë të dukshme në sigurimin e përvojave të të nxënit që janë në përputhje me objektivat e përcaktuara akademike.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke mbështetur stafin akademik në aplikimin dhe përfshirjen në mobilitete për trajnime dhe mësimdhënie në universitete të ndryshme. Në kuadër të programeve si Erasmus+, këto mobilitete kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e aftësive didaktike të stafit akademik, duke sjellë ide inovative dhe një frymë të re në departamentet përkatëse. Kjo përvojë ndërkombëtare ka përforcuar më tej cilësinë e procesit mësimor dhe ka ndihmuar në përshtatjen e praktikave mësimore me kërkesat bashkëkohore.</p> <p>Fakulteti i Edukimit (FE), si një strukturë akademike e përkushtuar ndaj cilësisë, nxit vazhdimisht përmirësimin e kompetencave didaktike të stafit. Si pjesë e kësaj strategjie, organizohen rregullisht analiza vjetore, si në nivel departamenti ashtu edhe fakulteti, ku shqyrtohet përputhja e metodave të mësimdhënies me objektivat formuese të programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion, u theksua rëndësia e këtyre analizave si</p>

<p>marrëdhëniet të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>një praktikë e mirë për reflektim dhe zhvillim profesional, duke përfshirë diskutime të strukturuar me stafin akademik mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë mësimore.</p> <p>Aktivitetet për zhvillimin profesional të stafit akademik përfshijnë gjithashtu organizimin e leksioneve të hapura, ku ftohen ekspertë të shquar nga fusha të ndryshme për të ndarë njohuri dhe praktika të avancuara. Këto aktivitete jo vetëm që kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të stafit, por gjithashtu ndihmojnë studentët në pasurimin e përvojës së tyre akademike dhe praktike.</p> <p>Programi MPGJL është projektuar për të përgatitur studentët me kompetenca të avancuara profesionale, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive që përputhen me kërkesat e tregut të punës dhe sfidat bashkëkohore në fushën e edukimit. Kjo qasje reflekton angazhimin institucional për përsosmëri akademike dhe përgatitje profesionale.</p> <p>Gjatë bisedave me stafin akademik dhe drejtuesit gjatë vizitës në institucion, u evidentua se këto iniciativa dhe aktivitete janë përqafuar gjerësisht si një mjet për përmirësimin e cilësisë dhe për arritjen e standardeve të larta akademike.</p> <p>Referencat mbështetëse: <i>Evidence 46, Raport mbi trajnimet Erasmus; 49 Kodi i Etikës; 48, Analiza vjetore e Dgish; 47 Analizë vjetore FE; 50 Pyetësor nga studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, nga takime me grupe të ndryshme studentësh, por edhe nga konsultimi me dokumentacionin e paraqitur në RVB, konstatohet se për vlerësimin e procesit dhe të formave dhe të metodave të mësimdhënies merret edhe mendimi i studentëve.</p> <p>Departamenti i Gjuhës shqipe e Letërsisë në analizat vjetore të tij vlerëson përputhjen e metodave të përdorura të mësimdhënies me objektivat formuese. Qëllimi kryesor i departamentit është të përmirësojë teknikat e mësimdhënies dhe këtë e realizon duke përfshirë edhe studentët në këtë proces. Për çdo vit studentëve i drejtohet një pyetësor ku vlerësohen format e përdorura nga lektorët në auditor dhe më pas sygjerimet e tyre reflektohen në departament. Mënyrat dhe format e mësimdhënies të përdorura në programin e studimit janë të shprehura në Nenin 68, pika 8 e Rregullores së UAMD-së dhe në Rregulloren se FE. Duke marrë parasysh kërkesat</p>




	<p>e studentëve, Universiteti "Aleksandër Moisiu" ofron dhe Shkollën e Verës.</p> <p><i>Evidenca 50: Pyetësor nga studentët</i> <i>Evidenca 51: Pyetësot UAMD</i> <i>Evidenca 20: Rregullore e FE</i> <i>Evidenca 52: Model Syllabus</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe për të plotësuar kërkesat ligjore, në UAMD është miratuar dhe funksionon Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në të cilën përcaktohet qëllimi i vlerësimit, objektet e vlerësimit, metodat dhe instrumentet e vlerësimit, vlerësimi i programeve, vlerësimi i studentëve, si edhe vlerësimi i shërbimeve, etj. Institucioni promovon përmirësime të vazhdueshme të mësimdhënies dhe zhvillimit të metodave inovative duke pasur prioritet ndryshimet në metodologji. QEV harton një plan trajnues mbi stafin në bashkëpunim me Departamentin e Pedagogjisë.</p> <p><i>Evidencë 11: Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Ci.pd</i> <i>Evidencë 45, Udhëzues për metodat e mësimdhënies.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë zhvillimit të programit të studimit Master Profesional në "Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsi", përdoren një larmi formash të mësimdhënies dhe të të nxënit, si leksione, seminare, lexime të ndryshme, projekte, dokumente, punë grupi, prezantime, zgjidhje problemesh, etj.</i></p> <p><i>Mësimdhënia realizohet në një formë inovative përmes zhvillimit të moduleve dinamike dhe të mirëorganizuara, të cilat inkurajojnë mendimin dhe punën e pavarur dhe e zhvendosin fokusin tek studenti.</i></p>

	<i>Kontrulli dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies rregullohet përmes zbatimit të Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave shkencore në programin Master Profesional është i rregulluar nga Rregullorja e Programit të Studimit dhe Rregullorja institucionale. Këto dokumente përcaktojnë standarde të unifikuara për të gjitha lëndët dhe janë të aksesueshme për studentët përmes faqes zyrtare të Fakultetit të Edukimit (FE) dhe Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), si dhe përmes sekretarisë mësimore. Studentët janë të informuar në mënyrë transparente për këto kriteret dhe metoda, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar.</p> <p>Komponentët e vlerësimit</p> <p>Vlerësimi i performancës së studentëve bazohet në pikët e grumbulluara nga komponentët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm – përbën 40% të totalit të pikëve dhe realizohet në javën e 8-të të semestrit. 2. Provimi përfundimtar – përbën 50% të totalit të pikëve dhe zhvillohet në javën e 15-të, pas përfundimit të semestrit. 3. Projektet/detyrat e kursit – përbëjnë 10% të totalit të pikëve dhe vlerësohen gjatë semestrit. <p>Nëse studenti nuk arrin të grumbullojë pikët minimale të nevojshme për të kaluar lëndën:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Ai/ajo ka mundësinë të rifrekuentojë lëndën në vitin akademik pasardhës, ose • Ta regjistrojë për riprovim unik, ku vlerësimi është deri në 1000 pikë. Ky riprovim zhvillohet në sezonet përkatëse (dimër, verë, vjeshtë). <p>Sistemi i vlerësimit me pikë dhe nota Vlerësimi i përfunduar bazohet në pikët e grumbulluara, duke u përkthyer në notat përkatëse si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nota 4: 0 – 504 pikë • Nota 5: 505 – 574 pikë • Nota 6: 575 – 664 pikë • Nota 7: 665 – 754 pikë • Nota 8: 755 – 844 pikë • Nota 9: 845 – 934 pikë • Nota 10: 935 – 1000 pikë <p>Qasja e Vlerësimit</p> <p>Kjo strukturë vlerësimi siguron një qasje të drejtë, të standardizuar dhe të bazuar në performancë për të gjithë studentët. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, të kombinuara me projektet dhe detyrat e kursit, krijojnë një ekuilibër ndërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar. Përmes fleksibilitetit të ofruar për rifrekuentimin ose riprovimin, institucioni garanton mundësinë e përmirësimit të performancës akademike, duke përmbushur standardet e larta të cilësisë dhe objektivat e programit.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të mësimet FE organizon javën e orientimit për të informuar studentët e viteve të para në lidhje me rregullat e vlerësimit.</p> <p>Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen nga Pedagogu i lëndës në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Informacioni jepet i plotë dhe i hollësishëm si dhe ftohen studentët ta ndjekin zbatimin me përpikmëri të syllabusit të lëndës, duke vjelë informacionin në fund të çdo semestri nëpërmjet pyetsorëve.</p>

	<p>Informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë tregohen në Katalogun e Përshkrimit të Moduleve në të cilën tregohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ lloji i lëndës/modulit; ○ totali i krediteve (ECTS); ○ emri i lektorit; ○ qëllimi i modulit; ○ rezultatet e të nxënit; ○ literatura bazë dhe ajo e rekomanduar; ○ metodologjia e mësimdhënies; ○ mënyra e vlerësimit. <p><i>Evidenca 5: Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 51: Pyetesor</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave shkencore realizohet nëpërmjet metodave të ndryshme, duke krijuar hapësira për studentët që të demonstrojnë në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit të studimit. Kjo qasje e larmishme pasqyron karakteristikat specifike të lëndëve dhe synon të sigurojë një vlerësim të drejtë dhe të balancuar për secilin student. Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit janë të përshkruara qartë në syllabus-in e çdo kursi, duke iu përmbajtur rigorozisht dispozitave të përcaktuara në aktet rregullatore të Fakultetit të Edukimit (FE) dhe Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD). Kjo siguron një transparencë të plotë dhe përputhshmëri me standardet akademike të institucionit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për këtë Program Studimi kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve tregohen në Rregulloren e programit të studimit, e cila është publike dhe studentët njihen me të prej momentit të fillimit të studimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale është një proces integral dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Ky proces reflektohet në vlerësimin përfundimtar, i cili është i përcaktuar qartë në syllabus-in e çdo lënde apo moduli, dhe hartohet nga titullari i lëndës/modulit në përputhje me objektivat mësimore dhe rregulloret institucionale. Në vlerësojmë që përdorimi i një sistemi të strukturuar pikëzimi prej 1000 pikësh për të matur shkallën e përvetësimit të programit mësimor është një praktikë transparente dhe standardizuese. Ky sistem lejon një konvertim të qartë dhe të drejtë të pikëve në notë, ku nota kaluese më e ulët është "5", që korrespondon me 51% të pikëve të grumbulluara. Ky prag minimal siguron një vlerësim objektiv të kompetencave bazë të studentit. Për më tepër, vlerësimi realizohet në mënyrë të balancuar gjatë gjithë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga komponentët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) – një pikë kritike që ofron një vlerësim të hershëm të progresit akademik të studentit. 2. Provimi përfundimtar (50%) – që siguron një vlerësim gjithëpërfshirës të rezultateve të të nxënit. 3. Projektet/detyrat e kursit (10%) – të cilat stimulojnë angazhimin praktik dhe aftësinë për të aplikuar teorinë në situata reale. <p>Nga perspektiva jonë, kjo qasje është në përputhje me standardet ndërkombëtare të akreditimit dhe garanton që procesi i vlerësimit të jetë gjithëpërfshirës, i drejtë dhe i orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë mësimore. Integrimi i vlerësimit të ndërmjetëm dhe të përfundimtar, së bashku me projektet praktike, pasqyron një qasje moderne që përforcon rezultatet e të nxënit dhe rrit përgatitjen profesionale të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projektit Clean Score, i mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Ky projekt synon modernizimin e procesit të testimit dhe vlerësimit nëpërmjet integritit të një sistemi elektronik të dedikuar.</p>




	<p>Sistemi Clean Score, si një platformë teknologjike për testim dhe vlerësim elektronik, ofron mundësi për rritjen e transparencës dhe objektivitetit në procesin e vlerësimit të studentëve. Personeli akademik i Fakultetit të Edukimit (FE) ka mundësinë të aplikojë këtë metodë në mënyrë vullnetare, duke pasur në dispozicion të plotë mbështetjen teknike dhe logjistike të sistemit.</p> <p>Në përputhje me respektimin e autonomisë akademike dhe specifikave të veçanta të çdo lënde, përdorimi i kësaj platforme mbetet një zgjedhje e lirë e pedagogut. Kjo fleksibilitet siguron që zbatimi i sistemit të përshtatet me nevojat dhe objektivat pedagogjike të lëndës/modulit, duke ruajtur një qasje të personalizuar dhe të qëndrueshme.</p> <p>Referencë mbështetëse: Evidence 53, Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në përputhje me standardet e përcaktuara dhe aktet rregullatore në fuqi, Katalogu i Përshkrimit të Moduleve për secilën lëndë përfshin metodologjinë e mësimdhënies dhe mënyrën e vlerësimit. Procesi i vlerësimit përfundimtar të çdo lënde zhvillohet në bazë të syllabus-it përkatës, duke respektuar kërkesat e përcaktuara nga kuadri ligjor dhe akademik.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të programit mësimor matet përmes një sistemi pikëzimi prej 1000 pikësh, i cili përkthehet në notë në proces-verbalin përfundimtar. Nota minimale kaluese është "5", e cila korrespondon me 51% të pikëve të fituara. Ky sistem vlerësimi siguron një qasje transparente dhe të standardizuar në matjen e performancës së studentëve.</p> <p>Komponentët e vlerësimit janë të strukturuar si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm – kontribuon me 40% të totalit të pikëve dhe realizohet në mes të semestrit. 2. Provimi përfundimtar – përbën 50% të totalit të pikëve dhe zhvillohet në përfundim të semestrit. 3. Projektet/detyrat e kursit – përbëjnë 10% të totalit të pikëve dhe vlerësohen gjatë semestrit.

	<p>Kjo qasje e strukturuar mundëson një vlerësim gjithëpërfshirës të rezultateve të të nxënit, duke kombinuar vlerësimin e vazhdueshëm gjatë semestrit me atë përfundimtar. Ajo garanton jo vetëm drejtësi dhe saktësi në procesin e vlerësimit, por edhe përputhjen me standardet ndërkombëtare të cilësisë në arsimin e lartë.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me personelin akademik dhe studentët e përfshirë në këtë program studimi, u evidentua një angazhim i dukshëm për të siguruar një proces vlerësimi gjithëpërfshirës dhe transparent. Pedagogët e lëndëve që kontribuojnë në zhvillimin e programit aplikojnë një praktikë të vazhdueshme të dhënies së komenteve për studentët, si në formë të shkruar, ashtu edhe verbalisht, gjatë të gjitha fazave të vlerësimit të vazhduar. Këto komente shërbejnë si një mekanizëm për përmirësimin e performancës së studentëve, duke i orientuar ata drejt arritjes së rezultateve të pritshme të të nxënit.</p> <p>Në përputhje me rregulloret institucionale, çdo pedagog ka të drejtën e autonomisë në interpretimin dhe prezantimin e rezultateve të vlerësimit, në varësi të specifikave të lëndës/modulit. Ky fleksibilitet u lejon pedagogëve të përshtatin procesin e vlerësimit me kërkesat dhe objektivat specifike të kursit, duke garantuar një qasje të personalizuar dhe efektive ndaj nevojave të studentëve.</p> <p>Fakulteti i Edukimit (FE) siguron të drejtën e studentëve për t'u njohur me rezultatet e vlerësimit të tyre, duke ofruar informacione të detajuara mbi mënyrën e vlerësimit, përfshirë identifikimin e gabimeve të bëra gjatë testimit. Për çdo provim, personeli akademik informon studentët për datën, vendin dhe orarin kur ata mund të diskutojnë dhe të ballafaqojnë rezultatet e provimeve. Pas përfundimit të këtij procesi, rezultatet përfundimtare regjistrohen në procesverbal dhe në sistemin elektronik, duke respektuar afatin maksimal prej 72 orësh nga dita e provimit, siç përcaktohet në Rregulloren e Provimeve (Evidence 5). Nga perspektiva jonë si eksperte, ky proces reflekton një standard të lartë të transparencës dhe përfshirjes studentore. Praktika e ofrimit të komenteve të detajuara, ballafaqimit të rezultateve dhe respektimit të afateve të përcaktuara ligjërisht garanton një qasje profesionale dhe etike në procesin e vlerësimit. Këto masa forcojnë besimin e studentëve në integritetin e procesit akademik dhe kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit.</p>




	<i>Evidence 5, Rregullore e provimit</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Fakulteti i Edukimit (FE) dhe Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë ndjekin një qasje të rreptë në lidhje me plagjiaturën dhe kopjimin në provime apo detyra, duke mbështetur standardet më të larta të integritetit akademik. Plagjiatura dhe kopjimi janë rreptësisht të ndaluara për studentët dhe përbëjnë shkelje serioze të rregulloreve akademike.</p> <p>Në rastet kur studenti thyen rregullat e provimit, procesi ndërpritet menjëherë. Personeli akademik i kursit, së bashku me asistuesin përkatës, plotësojnë një procesverbal për dokumentimin e parregullsive në provim. Ky procesverbal i bashkëngjitet materialit të provimit, i cili vlerësohet me 0 pikë, duke reflektuar penaltetin për shkeljen e rregullave.</p> <p>Kjo politikë strikte synon të promovojë ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë në procesin akademik, duke garantuar një mjedis mësimor të bazuar në meritokraci dhe etikë profesionale. Implementimi i këtyre masave ndihmon në ruajtjen e cilësisë dhe besueshmërisë së rezultateve akademike në përputhje me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p><i>Evidencë 49 Kodi i Etikës</i></p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve publikohen në përputhje të plotë me përcaktimet e Rregullores së Universitetit, Rregullores së Fakultetit të Edukimit (FE) dhe Rregullores së Programit të Studimit përkatës. Gjatë vizitës në institucion, u vërejt një angazhim i qartë për respektimin e këtyre rregulloreve dhe një zbatim rigoroz i afateve dhe procedurave të vlerësimit.</p> <p>Në përputhje me këto dispozita, rezultatet e provimeve regjistrohen në sistemin elektronik Pitagora brenda një afati maksimal prej 72 orësh nga zhvillimi i provimit. Ky proces siguron që studentët të kenë akses në rezultatet e tyre në kohë reale, një praktikë kjo e cila u konfirmua edhe gjatë intervistave me personelin akademik dhe studentët. Studentët vlerësuan transparencën dhe efikasitetin e sistemit, duke theksuar rëndësinë e publikimit të shpejtë të rezultateve për vazhdimësinë e procesit akademik.</p>




<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni siguron që laboratorët, studiot, atelietë dhe mjediset e tjera, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit, të jenë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për realizimin e kërkesave të moduleve. Këto mjedise mbështesin aftësimin teorik dhe praktik të studentëve, duke kontribuar në përmbushjen e objektivave formues të programit të studimit.</p> <p>Sallat e leksioneve janë të pajisura me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Internet me shpejtësi të lartë, për të mbështetur aksesin në burimet elektronike të informacionit; • Pajisje për mësimin audioviziv, të cilat lehtësojnë një qasje interaktive dhe bashkëkohore të mësimdhënies. <p>Për të mbështetur personelin akademik në detyrat e tyre mësimore dhe kërkimore, çdo pedagog është i pajisur me një laptop personal, duke siguruar akses të lehtë në teknologjitë digjitale dhe burimet akademike. Kjo praktikë rrit efikasitetin e mësimdhënies dhe përgatitjes së materialeve, duke u përshtatur me standardet moderne</p>




	të arsimit të lartë. Kjo qasje integruese e infrastrukturës dhe pajisjeve mbështetëse garanton një mjedis të përshtatshëm për realizimin e suksesshëm të procesit mësimor dhe kërkimor, duke u përmbushur standardet më të larta akademike dhe nevojat e studentëve dhe pedagogëve.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për nevoja të studentëve , për praktika shfrytëzohet laboratori brenda FE që është në dispozicion edhe të programeve të tjera me kapacitet 20 PC projektore HD për zhvillimin e procesit mësimor në kushte optimale, një laborant të dedikuar vetëm për mirëmbajtjen teknike të këtij laboratorit dhe për të asistuar stafin akademik që zhvillon procesin mësimor dhe praktikat në këtë laborator.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	Për natyrën e këtij program janë të mjaftueshëm auditorët që disponon FE. Ky fakultet ka në dispozicion edhe auditorë mësimorë me kapacitet total 420 vende (sallat 104, 105, 107, 108, 110, 210 të cilat mund të shihen edhe te Harta e mjediseve.
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se ky standard është plotësuar. Gjatë inspektimit të realizuar në të gjitha ambientet e institucionit, u vu re se infrastruktura ishte e mjaftueshme, e

	<p>përputhur me kërkesat e programit të studimit dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë.</p> <p>Mjediset ishin të pajisura me aparatura dhe mjete moderne, të përshtatshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor dhe interaktiv. Sallat e leksioneve ofronin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Internet funksional dhe me shpejtësi të lartë, duke mbështetur qasjen në burime elektronike të informacionit. • Pajisje audiovizive, të cilat nxisin përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit. <p>Gjithashtu, mjediset laboratorike dhe studiot përmbanin të gjitha pajisjet e nevojshme për përmbushjen e kërkesave praktike dhe teorike të programeve të studimit. Personeli akademik kishte në dispozicion laptopë personalë, duke garantuar një mbështetje teknologjike efektive për përgatitjen dhe realizimin e mësimdhënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse që vihet në dispozicion të studentëve përbën një element kyç për arritjen e objektivave akademike të programit të studimit. Literatura siguron qasje në dijet dhe njohuritë e nevojshme, të përcaktuara në syllabus-in e çdo lënde, dhe përmbush një sërë kërkesash për cilësi dhe përditësim, duke përkrahur një proces të plotë dhe efektiv të të nxënit.</p> <p>Literatura bazë dhe ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëkohore dhe në gjuhën shqipe: Literatura që shoqëron syllabuset e lëndëve është e përzgjedhur me kujdes për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse. Ajo siguron që studentët të kenë akses në burime të përditësuara

	<p>dhe të përshtatura për kontekstin lokal dhe ndërkombëtar, duke garantuar cilësi në procesin mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • E aksesueshme fizikisht dhe digjitalisht: Literatura ndihmëse, përfshirë librat, artikujt shkencorë dhe materialet digjitale, mund të merret në bibliotekën e Fakultetit të Edukimit. Biblioteka jo vetëm që ofron burime fizike, por gjithashtu mundëson qasje në bibliotekën digjitale përmes një platforme të dedikuar, siç përshkruhet në Manualin e Bibliotekës Digjitale (Evidencë 65). <p>Mbështetja për studentët në procesin e studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qasja në burime cilësore: Përmes qasjes në burime të shumta, studentët kanë mundësinë të eksplorojnë tema të thelluara dhe të ndërtojnë njohuri të qëndrueshme, duke kombinuar literaturën bazë me burime ndihmëse për të përmbushur kërkesat akademike të çdo lënde. • Lehtësimi i procesit të hulumtimit: Biblioteka e Fakultetit ofron një gamë të gjerë literaturash dhe burimesh shkencore që ndihmojnë studentët në realizimin e punimeve kërkimore, projekteve dhe përgatitjen për provime. <p>Institucioni, përmes përzgjedhjes së kujdesshme të literaturës dhe qasjes së lehtësuar në burime të ndryshme, garanton një përvojë gjithëpërfshirëse dhe të pasur akademike, duke siguruar që studentët të jenë të pajisur me njohuri dhe kompetenca të avancuara për të përmbushur kërkesat e programit të studimit dhe të tregut të punës.</p> <p>(Evidencë 65, Manual i bibliotekës digjitale)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësitë bazë, në procesin e hartimit dhe paraqitjes së syllabus-eve për lëndët e programit të studimit, kanë një përgjegjësi kyçe për shqyrtimin dhe integrimin e literaturës së përditësuar. Ky proces është një komponent thelbësor për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e përmbajtjes akademike me zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse.</p> <p>Gjatë hartimit të syllabus-it, njësitë bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analizojnë literaturën ekzistuese: Shqyrtojnë materialet e propozuara në syllabus-et e mëparshme për të identifikuar




	<p>nevojën për përditësime, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore, teknologjike dhe profesionale.</p> <p>2. Konsultojnë burime bashkëkohore: Sigurojnë që literatura e përfshirë të pasqyrojë botimet më të reja dhe më relevante në fushën përkatëse, duke garantuar që studentët dhe pedagogët të kenë qasje në materiale të përditësuara dhe me vlerë të shtuar akademike.</p> <p>3. Bashkëpunojnë me pedagogët dhe ekspertët e fushës: Marrin mendimet e personelit akademik dhe specialistëve për të identifikuar dhe përzgjedhur burimet më të përshtatshme që mbështesin objektivat e lëndës dhe programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>E UAMD ka në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik një bibliotekë moderne që ofron të gjitha mundësitë për shfrytëzim. Ajo është krijuar në vitin 20007 dhe është e ndarë në tri godina. Biblioteka nr. 2 e Fakultetit të Edukimit shtrihet në godinën nr.1. Ajo përmban 12000 mijë tituj (dok.nr. 38) kurse në RVB thuhet 8000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj. Ka një kapacitet prej 238.8 m² dhe 120 vende. Nga vizita në të vërejtëm se punonjëset ishin të përkushtuara, e njihnin mirë bibliotekën dhe na sqaruan se biblioteka funksionon sipas Ligjit nr 8576, 03.02.2000, neni 30, “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”. Kjo bibliotekë ka marrëdhënie me simotrat jashtë prej nga merr edhe tituj të rinj në shkëmbimet që bëhen. Biblioteka ka marrëdhënie dhe përfiton nga bashkëpunimi me UNRICD në Zvicër. Literatura që përmban është nga të gjitha lëmitë shkencore, por ne u përqëndruam në ato të gjuhës shqipe, letërsisë dhe anglisht. Pamë që në bibliotekë nuk mungonin periodikët e këtyre fushave si “Studime filologjike”, tekstet dhe litaratura e nevojshme për letërsinë.</p> <p>Në sallën e bibliotekës ka mundësi kërkimi i literaturës online, gjithashtu ka një sallë kompjuterash ku studentët mund të punojnë të vetëm apo në grup për realizimin e detyrave.</p> <p><i>(Evidencë 66 , Raportimi i bibliotekës)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të</p>	<p>Biblioteka ishte e pajisur me fond fizik për shumë nga tekstet mësimore dhe për ato që mungonin ishin depozituar ciklet e leksioneve. Fondi vlerësojmë se ishte i mjaftueshëm për këtë program studimi dhe pasurohej periodikisht me tituj të rinj. Në bibliotekë pamë listën e periodikëve për çdo program studimi të cilat studentët mund t’i aksesojnë dhe online. Biblioteka ka internet gjithë kohës.</p>


<p>huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të të gjithë studentëve pa pagesë në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p> <p>(Evidencë 66, Urdher për funksionimi e bibliotekës në fundjave)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka shfrytëzohet pa pagesë dhe online mund të shfrytëzohen të dhënat nga JSTOR, EPSCO, UNRISD. Çdo student e pedagog mund të hapë një kartelë pa pagesë dhe biblioteka disponon 2000 të tilla.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka universitare qëndron e hapur prej orës 8.00-16.00 brenda kohës kur studentët janë në proces mësimor. Online ajo mund të shfrytëzohet deri në orën 20.00.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në</p>	<p>Universiteti gjatë planifikimit të buxhetit vjetor, merr parasysh kërkesat e njësitë bazë në të cilat janë depozituar kërkesat e secilit pedagog për literaturë. Nuk pamë ndonjë dokument ku të pasqyrohej raportimi për cilësitë dhe kërkesën për përditësim të bibliotekës. Nga shqyrtimi në vend i bibliotekës, punonjëset na informuan për fondin fizik, mundësitë online etj. Se sa te efektshme kanë qenë propozimet për pasurimin e fondit, nuk kemi informacion.</p>




shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se litaratura, biblioteka në dispozicion të studentëve ishte e pasur dhe bashkëkohore. Kushtet që ofronte biblioteka ishin shumë të mira.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni, njësitë bazë përgjegjëse ndjekin gjithë ecurinë e studentëve nga regjistrimi deri në diplomimin e tij. Kjo arrihet me anë të strukturave përkatëse, si Sekretaria Mësimore, Zyra e karrierës dhe Alumnit dhe njësitë bazë. Në dokumentin nr. 64 "Model dosje studenti" jepet dokumentacioni i përcaktuar nga MASR për regjistrimin estudentit. Po kështu studenti pajiset me nr. Matrikulimi dhe rezultatet mësimore disponohen nga sekretaria mësimore.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	Në UAMD funksionon një sistem i brendshëm i menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit për stafin akademik, në letër dhe

<p>administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>në formë elektronike. Ky sistem monitoron arritjet shkencore, titujt akademike, ngarkesën e personelit të brendshëm dhe çdo të dhënë që nevojitet për të. Po kështu menaxhohen dhe të dhënat për stafin ndihmës akademik. Gjithë ky sistem përbëhet nga Njësia kryesore, Njësitë bazë, Dega mësimore, Dega e financës dhe ajo e burimeve njërezore.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Këto janë të përcaktuara dhe në dokumentin nr.31 Rregullore e MP. Studentë e pedagogë janë të informuar me programin, oraret, kanë akses në linkun e paraqitjes së rezultateve të provimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni përdor një qasje moderne dhe të integruar në menaxhimin dhe komunikimin akademik, duke shfrytëzuar teknologjitë digjitale si Sistemi Pitagora, Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) dhe platforma e studentit. Këto sisteme sigurojnë një komunikim të shpejtë dhe efikas midis studentëve, stafit akademik dhe administratës, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit në kohë reale.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pitagora: Shërben si një platformë për menaxhimin e procesit akademik, duke përfshirë regjistrimin e notave, planifikimin e mësimdhënies dhe komunikimin administrativ. • RASH: Ofron infrastrukturë digjitale për institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, duke përfshirë akses në rrjete akademike globale dhe mbështetje teknike për platformat online. • Platforma e studentit: Siguron një mjedis të dedikuar ku studentët mund të marrin informacion mbi programet e studimit, detyrat, materialet mësimore dhe komunikimin me pedagogët.
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim dhe raportim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative, duke ofruar të dhëna të sakta për organet dhe autoritetet drejtuese. Ky sistem mundëson:</p>




administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimin e procesit mësimor dhe administrativ. • Raportime individuale dhe kolektive për vendimmarrje të informuar. • Transparencë dhe efikasitet operacional. <p>Funksionimi i tij rregullohet nga Rregullorja e Fakultetit të Edukimit (FE), duke siguruar një kuadër të qartë dhe të strukturuar për zbatimin e tij. Sistemi kontribuon në përmirësimin e cilësisë dhe llogaridhënies në menaxhimin institucional.</p>								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit ëëë.UAMD. edu.al								
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se ky standard është plotësuar. Sistemi i menaxhimit i institucionit garanton monitorim dhe raportim në kohë reale, duke siguruar transparencë, efikasitet dhe përputhshmëri me kërkesat akademike dhe administrative. Gjithashtu, funksionimi i tij është në përputhje të plotë me rregulloret institucionale dhe standardet cilësore të arsimit të lartë.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin	Raportet financiare në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) nuk realizohen në nivel të veçantë për çdo program studimi, por në rang njësie kryesore ose në nivel institucional . Ky model menaxhimi siguron diversifikimin e

<p>e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>shpërndarjes së kostove dhe të ardhurave midis programeve të ndryshme të studimit që ofron institucioni. Në këtë mënyrë, burimet financiare, përfshirë grantet dhe të ardhurat e tjera, menaxhohen në mënyrë të centralizuar, duke pasqyruar efikasitet dhe përputhshmëri me strategjitë financiare institucionale. Evidenca 38 ("Pasqyra financiare e granteve") dëshmon për një qasje transparente dhe të strukturuar në menaxhimin e fondeve dhe shpërndarjen e tyre për mbështetjen e programeve akademike dhe administrimit të përgjithshëm. Kjo qasje lejon optimizimin e burimeve dhe mbulimin e nevojave të veçanta në funksion të prioriteteve strategjike të UAMD.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit i njësisë përgjegjëse për programin Master Profesional në Gjuhë dhe Letërsi (MPGJL) mbulon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Burimet njerëzore për realizimin e programeve. 2. Shpenzimet operative, përfshirë mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse. 3. Investimet në bibliotekë, literaturë bashkëkohore dhe akses në biblioteka online. 4. Detyrimet financiare dhe kontratat e shërbimeve që mbështesin mësimdhënien dhe projektet. <p>Departamenti harton çdo fillim viti një plan për blerje librash dhe abonime në revista ndërkombëtare për të përmirësuar cilësinë akademike dhe profesionale të stafit pedagogjik.</p> <p>Evidenca 26 (Raporti financiar 2018-2019), edhe pse i vjetër, shërben si model për analizimin e shpërndarjes së fondeve dhe optimizimin e tyre për një mësimdhënie cilësore dhe të përditësuar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton</p>	<p>Auditimi i Brendshëm dhe Vlerësimi Financiar në UAMD</p> <p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) realizon auditime të brendshme periodike për të vlerësuar dhe dokumentuar</p>

gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>gjendjen financiare dhe efektivitetin e menaxhimit të burimeve financiare. Ky proces ndihmon në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Monitorimin e rregullt të financimit, për të garantuar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe institucionale. 2. Identifikimin e problematikave dhe optimizimin e burimeve, duke rritur efikasitetin në shpërndarjen e fondeve. 3. Rritjen e transparencës në menaxhimin financiar, duke dokumentuar në detaje raportet dhe rekomandimet për përmirësime. <p>Auditimi i brendshëm siguron një mekanizëm kontrolli të vazhdueshëm që mbështet qeverisjen e mirë dhe ndihmon në përmirësimin e performancës financiare të institucionit.</p>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nga bisedat me kreret e departamenteve mësuam se UAMD raporton deri në nivelin e Departamentit të GJUHËS SHQIPE E LETERSISE për programin e studimit MPGJL mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Duke u mbështetur në raportet financiare, institucioni garanton vijueshmërinë duke pasur parasysh mënyrën e përmirësimit të situatës dhe risqet e mundshme			
Konkluzione	<i>GVJ vërejtë se shpenzimet financiare sipas zërave përkatës realizohen dhe shkojnë deri në njësitë bazë për të realizuar kërkesat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) harton dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë të gjitha fazat e ciklit akademik të studentëve, nga pranimi deri në përfundimin e studimeve, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë.</p> <p>Për programin Master Profesional në Gjuhë dhe Letërsi (GJL):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kriteret e pranimit hartohen nga njësitë përgjegjëse (Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë - DGJSH, Departamenti i Letërsisë - DL) dhe kalojnë për miratim në rektorat, senat akademik dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). • Informacioni publik: Të gjitha kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme në faqen zyrtare të UAMD dhe portalin U-Albania, duke garantuar transparencë dhe qasje të lehtë për publikun. • Shpallja e fituesve dhe regjistrimi: Realizohet në përputhje me udhëzimet dhe afatet e përcaktuara nga MAS. Procesi përfshin publikimin e listave të fituesve dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm brenda afateve të përcaktuara. <p>Evidenca 64 (Dosje studenti): Pasqyron zbatimin e këtyre politikave dhe procedurave, duke përfshirë dokumentacionin për pranimin, regjistrimin dhe përparimin akademik të studentëve.</p>

	<p>Kjo qasje garanton një proces të rregullt, transparent dhe në përputhje me legjislacionin, duke siguruar që të gjithë studentët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në respektim të standardeve institucionale dhe ligjore.</p> <p><i>Evidence 64, Dosje studenti</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni. Politikat e UAMD, të materializuara në rregulloret e tij, garantojnë kushte të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrjen e shërbimeve në UAMD; • Vlerësimin në provime; • Rregjistrimin në konkurset e pranimit dhe zhvillimin e tyre; • Mbrojtjen e diplomës; • Promovimin në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë institucionit; • Ushtrimin e të drejtave të tyre sipas parashikimeve të rregullores së studimit dhe atë të programit. <p>Këto kriteret, procedura, kërkesa për transferim dhe të gjitha rregulloret e aktet rregullative janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të UAMD edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit MPGJL. Për transparencë i gjithë ky proces aplikohet në sistemin U-Albania ku çdo aplikant mund të informohet për rezultatin dhe ecurinë e aplikimit të tyre. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UAMD duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. Gjatë këtij procesi aplikantët kanë edhe mundësinë e ankimimit.</p> <p><i>Evidence 69, Raporti I transparences se ankimimeve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) dhe Fakulteti i Edukimit (FE) hartojnë dhe publikojnë kritere të veçanta për pranimin e kandidatëve në programet e studimit, duke garantuar transparencë dhe qasje të barabartë për të gjithë aplikantët.</p>




<p>përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>1. Hartimi i kriterëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Kriteret e pranimit propozohen nga Fakulteti i Edukimit (FE) dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD. ○ Këto kriterë përfshijnë kërkesat akademike, profesionale dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikantët. <p>2. Publikimi i informacionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Vendimet e Senatit Akademik dhe kriteret e pranimit publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. ○ Përveç kësaj, njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet për aplikim dhe regjistrim shpërndahen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të UAMD dhe FE, duke siguruar një qasje të gjerë dhe të aksesueshme për publikun. <p>Evidenca 68 (Kriteret e pranimit) pasqyron procesin formal dhe përmbajtjen e kriterëve të pranimit, duke përfshirë detajet e kërkesave dhe procedurat e përzgjedhjes.</p> <p>Kjo qasje siguron një proces të qartë, të drejtë dhe të bazuar në standarde të larta akademike, duke përmbushur angazhimin e UAMD dhe FE për transparencë dhe përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidence 68, Kriteret e pranimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) harton dhe publikon çdo vit akademik kriterë dhe kuota pranimi për programet e studimit që ofron, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto informacione janë të qarta, të detajuara dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku.</p> <p>1. Hartimi dhe publikimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Kriteret dhe procedurat e pranimit hartohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe aprovohen nga organet përkatëse të UAMD. ○ Informacioni publik vendoset në faqen zyrtare të UAMD, duke siguruar akses të lehtë për studentët dhe palët e interesuara. <p>2. Komunikimi dhe transparenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Përveç faqes zyrtare, njoftimet për kriteret e pranimit, kërkesat e veçanta dhe afatet shpërndahen në rrjetet sociale zyrtare të UAMD dhe Fakultetit të Edukimit (FE), duke arritur një audiencë më të gjerë.




<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Rezultoni se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UAMD, gjenden në çdo kohë plan programet për çdo program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që UAMD ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UAMD harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>Evidencë 3, Statuti UAMD, Aneks për personat me aftësi të kufizuara.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Rezultoni se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. UAMD harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) harton dhe zbaton politika të posaçme ndihme dhe bursash, duke mbështetur shtresat në nevojë dhe duke nxitur cilësinë e pranimit në programe studimi me përparësi strategjike për institucionin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. UAMD aplikon politikat shtetërore për ofrimin e bursave studentore për studentët që vijnë nga shtresa sociale të pafavorizuara. Për studentët me rezultate të larta akademike, UAMD zbaton skema mbështetëse për të shpërblyer performancën dhe për të inkurajuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. Politikat e bursave orientohen gjithashtu drejt promovimit të programeve me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis arsimit të lartë dhe tregut të punës.</p> <p>Këto politika jo vetëm që kontribuojnë në përmirësimin e aksesit dhe përfshirjes në arsimin e lartë, por gjithashtu luajnë një rol kyç në rritjen e cilësisë akademike dhe përgatitjen e profesionistëve që i përgjigjen nevojave të tregut dhe shoqërisë.</p>




Konkluzione	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UAMD, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online ne faqen zyrtare të ëeb-it.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë se UAMD, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) siguron informacion të plotë dhe të detajuar për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, duke garantuar transparencë dhe qasje të lehtë për të gjithë. Procedurat për kalimin nga një vit akademik në tjetrin, përfshirë kriteret e përparimit dhe detyrimet akademike, janë të disponueshme në faqen zyrtare të UAMD dhe në kënde të dedikuara të njoftimeve brenda fakulteteve. Informacioni publikohet në formate të qarta dhe të strukturuara, duke i mundësuar studentëve të kenë akses të drejtpërdrejtë në udhëzime dhe sqarime për ecurinë e tyre akademike.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) siguron që studentët të jenë të informuar në mënyrë të qartë dhe transparente mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat institucionale. Kriteret dhe procedurat për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të fituara në institucione të tjera publike ose private pasqyrohen në faqen zyrtare të UAMD. Njësitë përgjegjëse dhe zyrat e administrimit akademik ofrojnë udhëzime të personalizuara për studentët lidhur me dokumentacionin e nevojshëm, afatet dhe procesin e njohjes. Kjo qasje garanton që të gjitha njohjet e kualifikimeve të kryhen në mënyrë të

	drejtë dhe transparente, duke mbështetur mobilitetin akademik dhe integrimin e studentëve në programet e studimit të UAMD.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UAMD informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit, nëpërmjet faqes Eëb dhe këndeve të njoftimit Konstatojmë se bazuar në Rregulloren e UAMD, në Rregulloren e ciklit të II të studimit Master dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master Profesional.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) siguron që studentët të jenë të mirëinformuar mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programet e studimit. Informacioni publikohet në kënde të dedikuara njoftimesh pranë sekretarive mësimore, duke ofruar udhëzime të qarta dhe të detajuara për çdo hap të procesit, nga përzgjedhja e temës deri te mbrojtja përfundimtare. Ky informacion përfshin: <ul style="list-style-type: none"> • Afatet dhe procedurat administrative për dorëzimin e temave dhe dokumentacionit të nevojshëm. • Kriteret akademike dhe metodologjike që duhet të ndjekin studentët gjatë hartimit të punimit të diplomës. • Udhëzimet për mbrojtjen e diplomës, duke garantuar që procesi të jetë i qartë dhe transparent.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UAMD publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.									
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban programi i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Master Profesional ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UAMD dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Konstatojmë që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikim i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet sistemit. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me format e vlerësimit për secilën lëndë, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional, në të cilën përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UAMD.

	<i>Evidenca: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Konstatohet se Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Njësia e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme që institucioni organizon.</p> <p><i>Evidencë 33. Kalendari i aktiviteteve - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.pdf</i></p>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) kanë në dispozicion informacion të gjerë dhe të përditësuar lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, duke përfshirë oraret, programet e studimit dhe metodologjitë e ndjekura. • Logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave. • Shërbimet mbështetëse, si hapësirat laboratorike, bibliotekat, pajisjet teknologjike dhe burimet online. <p>Ky informacion është i aksesueshëm përmes faqes zyrtare të universitetit, këndeve të njoftimeve dhe komunikimeve nga strukturat përgjegjëse, duke siguruar një mbështetje të plotë për studentët në përmbushjen e nevojave të tyre akademike dhe praktike.</p>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Informacioni mbi programin e studimit është i aksesueshëm për studentët përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit të UAMD. Ky sistem siguron qasje të lehtë dhe të shpejtë, duke mundësuar që studentët të marrin informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit, strukturën, oraret dhe detajet e tjera, edhe kur ndodhen në distancë.</p> <p>Kjo qasje e decentralizuar garanton transparencë dhe mbështetje efektive për studentët në përmbushjen e nevojave të tyre akademike.</p>
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që në faqen e internetit të UAMD gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UAMD dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, etj. Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si</i>

	<i>dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UAMD disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit, depozituar pranë Zyrës së Studentit <i>Evidencë 30, Info mbi studentët Alumni</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatë hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat për tre vite akademike janë si më poshtë: 2020-2021:43 studentë 2021-2022:37 studentë 2022-2023:12 studentë
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe	Të dhënat statistikore të studentëve në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) menaxhohen në mënyrë të sigurt dhe të strukturuar përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Ky sistem siguron: Ruajtje dhe përpunim të sigurt të të dhënave, duke respektuar standardet e privatësisë dhe mbrojtjes së informacionit. Verifikim të lehtë dhe të shpejtë, të mundësuar vetëm për personat e autorizuar. Ky menaxhim garanton integritetin e të dhënave dhe

lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	përdorimin e tyre për qëllime akademike dhe administrative në mënyrë të besueshme dhe transparente.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) mbështet një proces të strukturuar dhe të rregullt kontrolli përmes akteve institucionale, duke siguruar monitorim dhe vlerësim periodik në të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave dhe dokumentacionit të studentëve. Sekretaritetë mësimore, të cilat administrojnë dhe ruajnë dokumentacionin akademik të studentëve. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, që përdoret për përpunimin dhe qasjen e të dhënave statistikore dhe akademike.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konstatojmë se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sekretaria Mësimore gjithashtu, disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje.			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Konstatohet që studentët e UAMD janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Studentët e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) kanë përfaqësues të tyre në strukturat kryesore vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse të institucionit, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik, ku kontribuojnë në proceset e diskutimit dhe miratimit të politikave akademike. • Komisionet zgjedhore, si në nivel institucional ashtu edhe në nivel të njësive kryesore, ku ndihmojnë në mbikëqyrjen dhe organizimin e proceseve zgjedhore. • Komisionet e përhershme, si Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) dhe Këshilli i Etikës, ku japin kontribut në ruajtjen e standardeve akademike dhe të sjelljes etike në institucion. <p>Informacioni mbi procedurat e votimit, vendimet dhe funksionimin e këtyre strukturave është i aksesueshëm në faqen zyrtare të UAMD: www.uamd.edu.al, duke garantuar transparencë dhe përfshirje aktive të studentëve në qeverisjen institucionale.</p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit	Konstatohet se studentët janë të përfshirë në takimet e organizuara nga Institucioni, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për akreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj.

të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.									
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në bisedat me studentët u konstatua se, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës.								
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët e UAMD janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të insitucionit. Atyre u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) ka krijuar një sistem të strukturuar njësisht dhe procedurash të dedikuara për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve, në përputhje me

<p>informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Ky sistem synon të sigurojë transparencë, akses të lehtë në informacion dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë ciklit të tyre akademik.</p> <p>Gjatë procesit të aplikimit dhe regjistrimit në Master Profesional në Gjuhë dhe Letërsi (MPGJL), çdo student pajiset nga sekretaria mësimore me një set të plotë materialesh informative, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kurrikulën e programit të studimit, ku pasqyrohen: <ul style="list-style-type: none"> ○ Lista e lëndëve të përfshira në program. ○ Numri i krediteve për çdo lëndë, në përputhje me sistemin ECTS. ○ Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe strukturës së programit. ○ Tipologjia e lëndëve (me detyrim ose me zgjedhje). • Rregulloret dhe udhëzimet mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve, duke përfshirë informacion mbi procedurat akademike dhe administrative.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UAMD dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim, etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet aksesit në sistemin e notave.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim</p>	<p>Konstatojmë se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rumbullakëta, aktiviteve të ndryshme që institucioni organizon. Gjithashtu ky sektor ofron informacion për bursa, informacion në</p>




të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	lidhje me mobilitetet dhe progamet e shkëmbimeve jashtë vendit si dhe orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Konstatohet që Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka nisur procesin e gjurmimit të studentëve pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale.			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni UAMD ka hartuar një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, <i>(Evidence 45, Manual i metodologjië së mësimdhënies)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Sipas informacionit të dhënë nga përgjegjësit e departamenteve, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) përdor mekanizmat e vlerësimit dhe analizën e rezultateve të marra për të identifikuar dhe promovuar shembuj të praktikave të mira në procesin e mësimdhënies. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në evidentimin e sukseseve akademike, por gjithashtu shërben si një nxitje për personelin akademik për të përmirësuar më tej metodat e tyre të mësimdhënies, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe nevojat e studentëve. Përmes këtij procesi, UAMD garanton një qasje të vazhdueshme drejt rritjes së cilësisë në arsimin e lartë , duke mbështetur inovacionin pedagogjik dhe përmirësimin profesional të stafit akademik.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Ka vetëm një dokument Evidenca nr 17/1 ku studentët japin mendim për pedagoget, por ai pasohet nga një urdhër dhe nuk jep ide të qartë.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për	Nuk ka dokument apo të dhëna të tjera që tregojnë publikimin e vlerësimit të cilësisë.

monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.									
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në analizën vjetore të departamenteve përkatëse i mëshohet analizës së punës shkencore, ngarkesës mësimore, por nuk evidentohen problematike për përmirësimin e cilësisë.								
Konkluzione	<i>Nuk ka një pamje të qartë të monitorimit të cilësisë, gjithëpërfshirjes në këtë proces. Analizat e punës shkencore, e cilësisë etj kërkojnë edhe evidentim të problematikave dhe lënien e detyrave.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Në vitin 2019, me Vendim të Rektorit nr. 587/8, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) ngriti strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), të cilat funksionojnë në përputhje me Rregulloren e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Evidencë nr. 11). Krijimi i këtyre strukturave ka për qëllim garantimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të të gjitha aspekteve të veprimtarisë akademike dhe administrative të institucionit.</p> <p>Roli dhe Funksionet Kryesore të SBC</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë akademike: 2. Garantimi i përputhshmërisë me standardet e cilësisë:.

	<p>3. Mbështetja e procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit:</p> <p><i>(Evidencë nr.11 Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në zbatim të nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBC), duke përcaktuar se përgjegjësia për sigurimin e cilësisë i takon Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë (NJBSC).</p> <p>Misioni i NJBSC përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor, kërkimor dhe administrativ. • Realizimin e monitorimit dhe raportimit të rregullt për performancën dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. • Koordinimin e akreditimeve dhe zbatimin e masave për përmirësim. <p>Ky sistem garanton transparencë, përmirësim të qëndrueshëm dhe krijimin e një kulture cilësie në të gjitha nivelet e institucionit.</p> <p>NJBSC është ngritur edhe në nivel fakulteti për FE.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat janë të përshkruara qartë në pjesën gjashtë të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). • Në Raportin e Vetëvlerësimit (RVB), i referohet një dokumenti përkatës (Evidencë 21), i cili, megjithatë, nuk është gjendur në dokumentacionin e dorëzuar. <p>UAMD ka kaluar me sukses procesin e Akreditimit Institucional dhe është vlerësuar me një Akreditim për periudhën e 5 viteve akademike, duke konfirmuar përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe angazhimin për përmirësim të vazhdueshëm në proceset akademike dhe administrative.</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit Master Profesional në Gjuhë dhe Letërsi (MPGJL), Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe koordinatori i programit hartojnë raporte periodike të vetëvlerësimit, të cilat i paraqiten për miratim Senatit Akademik. Këto raporte shërbejnë si bazë për identifikimin e arritjeve dhe nevojave për përmirësim.</p> <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC) ka rol thelbësor në këtë proces, duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitoruar dhe vlerësuar procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit. • Analizuar dhe krahasuar rezultatet bazuar në treguesit e cilësisë dhe në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Cilësisë dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse. <p>Kjo qasje e integruar garanton një sistem të qëndrueshëm për sigurimin e cilësisë, duke kontribuar në rritjen e standardeve akademike dhe administrative në të gjitha nivelet e institucionit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjeti të ngritur prej 2019 Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë mbështetur dhe me Vendimet dhe udhëzimet përkatëse nga kreu i UAMD:</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i programit Master Profesional në Gjuhë dhe Letërsi (MPGJL) realizohet çdo vit, pas përfundimit të regjistrimeve të studentëve për vitin akademik përkatës. Ky</p>




<p>dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>proces bazohet në të dhënat dhe analizat e grumbulluara përmes mjeteve si Pyetëtori i Vlerësimit të Programit (Evidencë 40).</p> <p>Koha e realizimit të vlerësimit është konsideruar optimale, pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshin studentët hyrës në procesin e vlerësimit, duke pasqyruar perceptimet dhe pritshmëritë e tyre të para ndaj programit. • Mundëson parashikimin e objektivave akademike, duke u bazuar në karakteristikat dhe profilin e studentëve të regjistruar, si dhe duke ndihmuar në përshtatjen e strategjive për zhvillimin e programit. <p>Ky proces kontribuon në një qasje të qëndrueshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara dhe duke reflektuar nevojat e vazhdueshme të studentëve dhe objektivat institucionale.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Cilësia e programit Master Profesional në Gjuhë dhe Letërsi vlerësohet përmes një qasjeje të strukturuar, duke analizuar elementët kryesorë që ndikojnë në standardet akademike dhe përvojën e studentëve. Procesi përfshin:</p> <p>a) Cilësinë dhe numrin e personelit akademik të angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqendrohet te kualifikimet, përvoja dhe aftësitë pedagogjike të stafit që kontribuon në mësimdhënie dhe zhvillimin e programit. <p>b) Cilësinë e materialeve mësimore dhe plotësuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson përputhshmërinë e materialeve mësimore me objektivat e programit, përditësimin dhe aksesin e studentëve në literaturë dhe burime ndihmëse. <p>c) Infrastrukturën mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon hapësirat dhe pajisjet e disponueshme për leksione, seminare, laboratorë dhe bibliotekën, duke u fokusuar në mbështetjen teknologjike dhe logjistike për mësimdhënien. <p>d) Ndërkombëtarizimin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shqyrton përfshirjen e programit në rrjete akademike ndërkombëtare, mobilitetin e studentëve dhe stafit, si dhe bashkëpunimet me universitete jashtë vendit. <p>e) Projekteve pjesëmarrëse:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> Analizon projektet kërkimore dhe bashkëpunimet institucionale ku përfshihet programi, duke vlerësuar ndikimin e tyre në përmirësimin e cilësisë dhe në zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit. <p>Këto elemente të vlerësimit sigurojnë një pasqyrë të plotë të standardeve dhe nevojave të programit, duke u përdorur për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë dhe për të përmbushur kërkesat akademike dhe profesionale.</p>
<p>Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për vlerësimin e MPGJL përdoren të dhënat e ofruara nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinioni i studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, opinioni i përfaqësuesve të biznesit, anketimi i studentëve të diplomuar etj.</p> <p>Gjithashtu analiza e pyetsorëve të studenteve është një tregues se si shkojnë punët në këtë program studimi. Në Evidencën nr.69 Rezultate të anketimit të studentëve, ata shprehen se janë të kënaqur me cilësinë dhe përgatitjen shkencore të stafit akademik. Po këshstu mendojnë se vlerësimi i provimeve prej pedagogëve është i saktë dhe i shpejtë.</p>
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Po nga analiza e pyetsorëve të studentëve të përmendur më lart, del mendimi i studentëve, lektorëve dhe stafit administrativ.</p> <p>Studentët shprehen disi të pakënaqur me mjetet e pamjaftueshme që vihen në dispozicion të tyre, pedagogët ankohen për pagat e ulëta, orët shtesë të paguara pak të cilat ndikojnë në mësimdhënie, literaturë e punë shkencore.</p>




administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>GVJ.mendon se mungon një analizë e drejtpërdrejtë e cilësisë për këtë program studimi. Mjetet e tërthorta si anketimi I studentëve janë bërë për të gjithë UAMD dhe jo specifikisht për këtë program, Kjo nuk lejon një pamje të qartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e	Në RVB thuhet se institucioni parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nuk ka asnjë të dhënë se si kryhet kjo
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në Evidencë 11, Rregullore e sigurimit të cilësisë UAMD përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit MPGJL garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore,

programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik, shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nuk kanë bashkëpunëtorë të jashtëm.			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se monitorimi i cilësisë duhet të jetë më i shpeshtë dhe me rezultate më konkrete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Megjithëse në RVB tregohet se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, nuk konstauam asnjë document se si dokumentohet dhe si iu bëjet e ditur palëve të interesuara, pedagogëe dhe student apo dhe publik</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nuk gjetëm asnjë të dhënë se si Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pyetësorët e vlerësimit të program, rezultatet që dolën prej tyre diskutohen me grupin e hartimit të kurrikulvs dhe hidhen projektpropozime për ndryshime, megjithëse siç vërejtëm edhe më lart, ato rezultate nuk janë enkas për këtë program studmi, por për gjithë UAMD.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ iu bë me dije se UAMD vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Në fund të cdo cikli hartohen dhe ploetësohen formularët që vlerësojnë programin e pvrpunohen të dhënat për përmirësim. Nuk pamë formularë të tillë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe</p>	<p>Studentët janë një aktor i rëndësishëm në zbatimin e politikave dhe strategjive të programit të tyre dhe është e pamundur që ata të përjashtohen nga veprimtaritë e SBC. Gjatë gjithë vitit akademik, koordinatori i MPGJL organizon takime periodike çdo javë duke përshtatur orarin e takimit me procesin mësimor. Në këto takime</p>




ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	studentët informohen me çdo aktivitet që lidhet me MSH/MI dhe me SBC. Këto takime shërbejnë edhe që studentët të shprehin opinionin e tyre dhe të informojnë drejtuesit e dgj e dl për çdo problematikë që ata mund të kenë.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se vlerësimi i cilësisë duhet të jetë më transparent e gjithëpërfshirës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësues për gjuhën shqipe dhe letërsinë” ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Pikat e forta

- **Staf akademik i kualifikuar:** Programi mbështetet nga staf akademik që i plotëson kërkesat shkencore dhe ka ekspertizën e nevojshme në fushën përkatëse.
- **Sistem i brendshëm i vlerësimit të cilësisë:** Është ngritur dhe funksionon një sistem efektiv për vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programit.
- **Infrastrukturë e përshtatshme:** Institucioni disponon sallat e leksioneve, laboratorët dhe bibliotekën e pajisur me teknologji bashkëkohore që mbështet mësimdhënien dhe të nxënit.
- **Mbështetje logjistike dhe teknologjike:** Studentët dhe personeli akademik kanë qasje në burime digjitale, internet me shpejtësi të lartë dhe pajisje moderne për lehtësimin e procesit akademik.
-

Pika të dobta

- **Ndërkombëtarizimi i kufizuar:** Ka nevojë për zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe krijimin e mundësive për mobilitetin e studentëve dhe stafit. **(Standardi 1.1, Kriteri 4)**
- **Angazhimi kërkimor i studentëve:** Ka hapësirë për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore dhe publikime akademike. **(Standardi III.4, Kriteri 1)**
- **Vlerësimi i cilësisë duhet të jetë më transparent e gjithëpërfshirës.** **(Standardi VI.5, Kriteri 2)**

Rekomandime

- **Pasurimi i literaturës dhe materialeve ndihmëse:** Të investohet në përfitësimin dhe diversifikimin e literaturës bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja.
- **Zgjerimi i ndërkombëtarizimit:** Të krijohen marrëveshje të reja bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare për të rritur mobilitetin dhe shkëmbimin e përvojave.
- **Nxitja e aktiviteteve kërkimore:** Të inkurajohet pjesëmarrja e studentëve dhe stafit në projekte kërkimore, seminare dhe publikime shkencore.
- **Monitorimi i cilësisë duhet të jetë më i shpeshtë dhe me rezultate më konkrete.**



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master. "Teacher of Albanian language and literature.", provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu"

Strengths

- **Qualified academic staff:** The program is supported by academic staff who meet scientific requirements and possess the necessary expertise in the relevant field.
- **Internal quality evaluation system:** An effective system for internal quality evaluation of the program has been established and is fully operational.
- **Adequate infrastructure:** The institution provides lecture halls, laboratories, and a library equipped with modern technology to support teaching and learning.
- **Logistical and technological support:** Students and academic staff have access to digital resources, high-speed internet, and modern equipment to facilitate academic processes.

Weaknesses

- **Limited internationalization:** There is a need to expand international collaborations and create opportunities for the mobility of students and staff. (Standard 1.1, Criterion 4)
- **Student engagement in research:** There is room to increase student participation in research projects and academic publications. (Standard III.4, Criterion 1)
- **Quality assessment should be more transparent and comprehensive.**(Standard IV.5, Criterion 2)

Recommendations

- **Enhancement of literature and supporting materials:** Invest in updating and diversifying core and supplementary literature in both Albanian and foreign languages.
- **Expansion of internationalization:** Establish new collaboration agreements with international universities and institutions to increase mobility and exchange of experiences.
- **Promotion of research activities:** Encourage greater participation of students and staff in research projects, seminars, and academic publications.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X